

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5539
E hënë, 30 korrik 2018
çmimi 0.40 €

FOL-i: Qeveria ka realizuar vetëm 57 për qind të planit të punës

Lëvizja FOL ka publikuar të dhënat statistikore të monitorimit të zbatimit të

Planit vjetor të punës së Qeverisë së Kosovës për periudhën janar-qershor të vitit 2018 | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de



FLET PËR "EPOKËN E RE", SHKËLZEN MALIQI

Opozita ta mbështesë dialogun

Analisti politik Shkëlzen Maliqi ka thënë se partitë opozitare në vend se të marrin masa obstruktive kundër finales së dialogut që nuk çojnë askund, duhet ta mbështesin këtë proces. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se LDK-ja do të bënte mirë nëse do ta ndihmonte dia-

logun, duke u dëshmuar si parti institucionale. Maliqi ka thënë se përfshirja e Luginës së Preshevës në dialog mund të jetë kushtëzim i Kosovës që t'i zvogëlojë ambiciet e Serbisë rreth Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Në këtë kontekst, ai ka theksuar se Beogradi nuk mund të kërkojë

autonomi për Asociacionin nëse nuk u jep shqiptarëve të Luginës të drejta dhe status të njëjtë. Maliqi duke folur për jetëgjatësinë e këtij koalicioni, ka thënë se kjo Qeveri e ka gjetur modusin e mbijetesës pasi opozita nuk po mund t'i mbledhë votat për mocion të mosbesimit | FAQE 4-5

NË KATEDRALEN "NËNË TEREZA" MBAHET MESHË PËR ADEM DEMAÇIN

Imzot Dodë Gjergji: Adem Demaçi kishte ideal lirinë dhe atdheun



Në Katedralen "Nënë Tereza" në Prishtinë është mbajtur të dielën meshë për Adem Demaçin, veprimtarin politik dhe aktivistin për të drejtat e njeriut, i cili vdiq të enjten në moshën 82-vjeçare. Në fillim të meshës u bënë lutje që shpirti i Demaçit të prehet në paqe. Ipeshkvi i Kosovës, Imzot Dodë Gjergji, ka thënë se Demaçi gjithë jetës së tij ka pasur ideal lirinë dhe dashurinë për kombin

Arifi-Krasniqi: Depozitat në Kosovë janë të siguruara

Drejtoresha menaxhuese e Fondit për Sigurimin e Depozitave në Kosovë, Violeta Arifi-Krasniqi, ka thënë se depozitat në Kosovë, bazuar në kompetencat ligjore që ka FSDK-ja, janë të siguruara në rast të revokimit të licencës së ndonjë banke nga BQK-ja



AKTUALE

MANDATI I TIJ, MANDAT I GJITHËKOHSHËM



Rexhep QOSJA

UNIVERSITETI I PRISHTINËS VAZHDON TË MBETET LIDER I UNIVERSITETEVE SHQIPFOLËSE

NË OKUK FILLON ZËVENDËSIMI I VALVULEVE TË ZEMRËS ME VALVULE BIOLOGJIKE

EKONOMI

PARA TË FALSIFIKUARA NË TREGUN E KOSOVËS

KULTURË

LIBËR ME NJË LARUSHI TË PASUR TEMATIKE

Bilall MALIQI

BINOMI HISTORI/LETËRSI NË VEPRIMTARINË E PROF. DR. SABILE KEÇMEZIT-BASHA

Prof. dr. Izber HOTI

SPORT

FEDERATA E FUTBOLLIT TË GJERMANISË KONFIRMON PËRKRAHJEN PËR SPORTIN E KOSOVËS

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht-Tetovë
Kurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net


DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Sot pritet të shpallet referendumi për emrin e ri të Maqedonisë

Kreu i Kuvendit të Maqedonisë, Talat Xhaferi, pritet ta shpallë datën e referendumit menjëherë pasi të jenë betuar anëtarët e rinj të KShZ-së. Referendumi për emrin pritet të mbahet më 30 shtator

SHKUP, 29 KORRIK - Sot (e hënë) pritet t'u jepet fund të gjitha dilemave rreth referendumit për marrëveshjen për çështjen e emrit. Kreu i Kuvendit, Talat Xhaferi, pritet ta shpallë datën e referendumit menjëherë pasi të jenë betuar anëtarët e rinj të KShZ-së. Referendumi për emrin pritet të mbahet më 30 shtator. Por, pushteti dhe VMRO DPMNE-ja opozitare duket se ende janë larg marrëveshjes për përmbytjen e pyetjes së referendumit. Partia e Mickovskit insiston se pyetja duhet të jetë e thjeshtë dhe me një kuptim. Nënkrjetari i VMRO-së, Aleksandër Nikollovski, në intervistë për "Evropën e Lirë" tha se cilado pyetje që, pos Marrëveshjes me Greqinë, do të përfshijë edhe integrimin në NATO dhe BE është kundërkushtuese.

"Pyetja e referendumit duhet të jetë e kuptueshme, e thjeshtë dhe e njëkuptimë. Kjo që e paraqet kryeministri është e shumëkuptimë, respektivisht ka së paku 8-9 kombinacione që mund t'i përgjigjen. Për shembull, mund të jeni pro anëtarësimit të Maqedonisë në BE, por të jeni kundër anëtarësimit të Maqedonisë në NATO dhe kundër Marrëveshjes me Greqinë dhe tani të mos i numëroj të gjitha kombinacionet. Kjo absolutisht është pyetje manipuluese, që është kundër ligjit. Kjo pyetje duhet të jetë shumë e thjeshtë dhe qytetarët të tregojnë se



a janë për apo kundër Marrëveshjes me Greqinë, e cila parashikon ndryshim të emrit", deklaroi Aleksandar Nikollovski, VMRO DPMNE.

Por zëvendëskryeministri Bujar Osmani tha se deri të hënë partitë do të përpiqen t'i harmonizojnë qëndrimet lidhur me pyetjen. Edhe në LSDM thonë se në rrjedhë e sipër janë konsultimet për mbylljen e të gjitha çështjeve të hapura që kanë të bëjnë me referendumin.

Sot (e hënë) shumica parlamentare do ta propozojë mbajtjen e referendumit më 30 shtator. Shpresojmë që

shpalljen do ta mbështesë edhe opozita. "Deri nesër po bëjmë tentim të dalim me pyetje të harmonizuara me opozitën", - tha Bujar Osmani, zv. Kryeministër.

Ditë më parë kryeministri Zaev tha se në rast se në referendum nuk arrihet konsensusi, për marrëveshjen me Greqinë do të vendosë Kuvendi. Pasi të mbarojë faza e referendumit, vijon ajo e ndryshimeve kushtetuese, pa çka marrëveshja do të ratifikohet në Kuvendin grek. Pas përfundimit të të gjitha procedurave, vendi do të bëhet anëtar i 30 i NATO-s.

Duhet kohë e gjatë për marrëveshjen Kosovë - Serbi

BEOGRAD, 29 KORRIK - Ambasadori kinez në Beograd, Li Mancheng, ka thënë se arritja e një marrëveshje në mes të Kosovës dhe Serbisë do të marrë kohë më shumë se disa muaj. Krejt kjo, sipas tij, është për shkak të rëndësisë dhe brishtësisë së kësaj çështje. "Për një pikëpyetje aq të madhe nuk duhet të lejohet që çështja të zgjidhet brenda pak muajsh. Normalisht, nëse Beogradi dhe Prishtina pajtohen për 10 ditë, i përgëzoj", ka thënë Mancheng. "Kina ka pritur gati 100 vjet për ta zgjidhur problemin me Hong Kongun, dhe një çështje e tillë është zgjidhur më 1997", ka thënë ai.

Ai ka shtuar se Kosova është çështja kryesore për shtetin serb, duke përsëritur se nuk duhet dhënë afate për arritjen e marrëveshjes së pritur.



"Është opinioni personal, jo zyrtar. Kur është puna te çështja e Kosovës, kjo i referohet sovranitetit dhe integritetit

territorial të Serbisë. Kjo është çështja kryesore për këtë shtet, Qeverinë dhe njerëzit këtu", ka thënë Mancheng.

LAJME SHKURT



Rama: Vettingu po godet me sukses korrupsionin

TIRANË, 29 KORRIK - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka reaguar pas akuzave të opozitës, duke i cilësuar akuzat e kësaj të fundit kundër procesit të vettingut si ato të frontit të dikurshëm demokratik të lagjes.

Reagimi i kreut të Qeverisë ka ardhur në rrjetet sociale. "Vettingu si ilaç gjarpërinjsh dhe opozita me libër shtëpie kundër vettingut si Fronti i dikurshëm Demokratik i lagjes! Në vend të letrave anonime janë shpifjet digjitale të Saliut. Në vend të këndit të fletërrufeve janë recituesit e Lulit. Në vend të kryetarit është vetë Luli", ka shkruar kryeministri në statusin e tij.



PD: Rama bllokon gjyqtarin e Strasburgut

TIRANË, 29 KORRIK - Emri i gjyqtarit të Shqipërisë në Gjykatën e Strasburgut ka qenë gjithmonë një çështje që ka përplatur frontet e politikës. S'kishte si të mungonin akuzat nga opozita edhe për listën e re triemërore të propozuar nga Qeveria së fundmi për postin e mbetur bosh si pasojë e refuzimeve nga Këshilli i Evropës të kandidatëve të propozuar më parë.

Nëpërmjet një deklarate për shtyp, ish-ministri i Drejtësisë, Gazmend Bardhi, ka akuzuar kryeministrin Edi Rama se prej dy vjetësh mban peng emërimin në Strasburg, pasi nuk heq dorë nga propozimi si kandidat i kunatit të Fatmir Xhafajt, ish-anëtarit të Gjykatës Kushtetuese Sokol Berberi. "Pavarësisht prej refuzimit disa herë nga Këshilli i Evropës të standardit të përzgjedhjes politike dhe korruptive të kandidatëve për gjyqtarë, Edi Rama nuk heq dorë. Për të pestën herë propozon si kandidat për gjyqtar në Strasburg kunatin e Fatmir Xhafës, Sokol Berberin, që është refuzuar me votë disa herë nga Këshilli i Evropës dhe i është shmangur vettingut", tha Bardhi.

Ai gjithashtu akuzoi Qeverinë se ka përzgjedhur si kandidat edhe Darien Palvin, një figurë e Fondacionit Soros në Shqipëri. "Edi Rama po shpërblen edhe Fondacionin Soros për ndihmën e vyer që i dha për projektin e kapjes politike të sistemit të drejtësisë. Kandidati tjetër alternativ që propozon Qeveria shqiptare për gjyqtar në Strasburg është Darien Pavli. Si drejtues i Sorosit ka qenë koordinator i Sekretariatit Teknik që ndihmoi Edi Ramën dhe Fatmir Xhafën ta hartonte paketën ligjore të kapjes së drejtësisë", tha Bardhi. Këshilltari ligjor i PD-së deklaroi se nëpërmjet dërgimit të personave të kontrolluar prej tij, Rama synon t'i përdorë në kundërshtim të interesave të qytetarëve shqiptarë në Strasburg.

Lëvizja FOL ka publikuar të dhënat statistikore të monitorimit të zbatimit të Planit vjetor të punës së Qeverisë së Kosovës për periudhën janar-qershor të vitit 2018

FOL-i: Qeveria ka realizuar vetëm 57 për qind të planit të punës



Prej 225 aktiviteteve sa kanë qenë të parapara në planin vjetor të punës së Qeverisë së Kosovës për periudhën janar-qershor të këtij viti, vetëm 130 apo 57 për qind janë realizuar. Këto janë rezultatet e hulumtimit të Lëvizjes FOL që janë publikuar të dielën. Sipas këtyre të gjeturave, vetëm Ministria e Financave, Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Ministria për Kthim dhe Komunitete kanë arritur t'i realizojnë të gjitha aktivitetet e parapara. Ndërkaq Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Infrastrukturës nuk kanë arritur të realizojnë asnjë aktivitet të parapara

Administrimit të Pushtetit Lokal në planin e punës kishte paraparë t'i realizojë 24 aktivitete nga të cilat vetëm një nuk ka arritur ta realizojë. Edhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik prej gjashtë aktiviteteve të parapara, vetëm një ka mbetur pa e realizuar për gjashtëmujorin e parë të këtij viti. Po ashtu, Ministria e Administratës Publike ka arritur t'i realizojë 13 aktivitete nga 16 sosh sa janë paraparë për periudhën gjashtëmujore. Performancë të mirë gjatë periudhës raportuese ka arritur të ketë edhe Ministria e Zhvillimit Rajonal, e cila ka realizuar shtatë aktivitete prej tetë sa kanë qenë të parapara. Gjithashtu edhe Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike ka përfunduar 12 aktivitete nga 15 sa kishte paraparë në planin vjetor të punës. Edhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka arritur t'i realizojë shtatë aktivitete prej 11 sa kishte planifikuar. Ndërkohë Ministria e Punëve të Brendshme në periudhën e parë gjashtëmujore ka planifikuar 14 aktivitete, nëntë prej të cilave i ka përfunduar. Po sipas të gjeturave të Lëvizjes FOL, Zyra e kryeministrit për periudhën e parë gjashtëmujore kishte paraparë t'i realizo-

jë 17 aktivitete në kuadër të planit vjetor, nga të cilat vetëm dhjetë i ka realizuar. Kurse Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, prej 11 aktiviteteve të planifikuara, ka arritur t'i përmbushë vetëm katër. Edhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, ndonëse kishte paraparë t'i realizojë 15 aktivitete, vetëm gjashtë prej tyre ka arritur t'i përfundojë. Ndërkaq Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për periudhën raportuese kishte planifikuar 20 aktivitete, ku vetëm tetë prej tyre i ka realizuar. Në këtë aspekt as Ministria e Drejtësisë nuk ka pasur performancë të mirë meqë prej 19 aktiviteteve të parapara për periudhën e parë gjashtëmujore, ka arritur t'i realizojë vetëm katër prej tyre. Kurse Ministria e Integritimit Evropian ka arritur t'i realizojë vetëm tri aktivitete nga 10 sosh sa ka planifikuar. Edhe Ministria e Shëndetësisë në kuadër të planit të punës ka realizuar tri aktivitete, nga 15 sa ishin të parapara. Sipas rezultateve të hulumtimit të Lëvizjes FOL, Ministria e Infrastrukturës dhe Ministria e Punëve të Jashtme nuk kanë realizuar asnjë aktivitet gjatë

periudhës së parë gjashtëmujore të vitit 2018. "Ministria e Punëve të Jashtme në gjashtëmujorin e parë ka planifikuar dy aktivitete, të cilat kanë mbetur të porealizuara në afatin e paraparë. Edhe Ministria e Infrastrukturës ka planifikuar pesë aktivitete në planin e punës të cilat kanë mbetur të papërfunduara sipas afatit të përcaktuar", është theksuar në komunikatën e FOL. Ndërsa Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, sipas të gjeturave të FOL-it, të gjitha aktivitetet e parapara në planin vjetor të punës së qeverisë për vitin 2018 ka planifikuar t'i realizojë deri në dhjetor të viti 2018. Kurse Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë nuk është përgjigjur në kërkesën e dërguar nga Lëvizja FOL sa i përket realizimit të punës për gjashtëmujorin e parë të këtij viti. Ndërkaq Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë s'ka paraparë asnjë aktivitet për periudhën janar-qershor të vitit 2018. Lëvizja FOL ka bërë me dije se disa nga ministritë kanë dhënë sqarime shtesë për të gjitha aktivitetet që nuk kanë arritur të përfundojnë sipas afatit të paraparë në planin vjetor të punës.

**EPOKA
ERE****Faton DERMAKU**

PRISHTINË, 29 KORRIK - Lëvizja FOL të dielën ka publikuar të dhënat statistikore të monitorimit të zbatimit të planit vjetor të punës së Qeverisë së Kosovës për periudhën janar-qershor të vitit 2018. Të gjeturat nga monitorimi i 22 institucioneve tregojnë se nga 225 aktivitete sa kanë qenë të parapara në këtë plan, vetëm 130 apo 57 për qind janë realizuar, ndërkaq 95 aktivitete apo 41 për qind kanë mbetur të papërfunduara në afatin e përcaktuar kohor. Në komunikatën e lëshuar nga Lëvizja FOL, është bërë me dije

se Ministria e Financave, Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Ministria për Kthim dhe Komunitete kanë arritur t'i realizojnë të gjitha aktivitetet e parapara në planin vjetor të punës së Qeverisë. "Ministria e Financave për periudhën e parë gjashtëmujore ka paraparë katër aktivitete të cilat i ka realizuar. Ministria për Komunitete dhe Kthim ka realizuar të gjitha aktivitetet e parapara për periudhën e parë gjashtëmujore. Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës ka realizuar tri aktivitete e parapara në planin njëvjeçar", është theksuar në komunikatë. Kurse Ministria e

Flet për "Epokën e re", Shkëlzen Maliqi

Opozita ta mbështesë



Analisti politik Shkëlzen Maliqi ka thënë se partitë opozitare në vend se të marrin masa obstruktive kundër finales së dialogut që nuk çojnë askund, duhet ta mbështesin këtë proces. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se LDK-ja do të bënte mirë nëse do ta ndihmonte dialogun, duke u dëshmuar si parti institucionaliste. Maliqi ka thënë se përfshirja e Luginës së Preshevës në dialog mund të jetë kushtëzim i Kosovës që t'i zvogëlojë ambicjet e Serbisë rreth Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Në këtë kontekst, ai ka theksuar se Beogradi nuk mund të kërkojë autonomi për Asociacionin nëse nuk u jep shqiptarëve të Luginës të drejta dhe status të njëjtë. Maliqi duke folur për jetëgjatësinë e këtij koalicioni, ka thënë se kjo Qeveri e ka gjetur modusin e mbijetesës pasi opozita nuk po mund t'i mbledhë votat për mocion të mosbesimit

**EPOKA
ERE****Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 29 KORRIK - Njohësi i proceseve politike në vend, Shkëlzen Maliqi, ka thënë të dielën se nëse gjithçka do të zhvillohet sipas parashikimeve optimiste, Kosova nga procesi i dialogut do të sigurojë njohje të pavarësisë nga Serbia dhe ulësen në OKB. Megjithatë, në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se nëse palët nuk arrijnë mar-

rëveshje, do të krijohet një konflikt objektivisht i ngrirë deri te një krizë e madhe evropiane ose botërore. "Finalen e dialogut e kërkojnë faktorët ndërkombëtarë, kurse Kosova dhe Serbia sikur nuk janë entuziaste. Liderët në Prishtinë dhe Beograd kanë frikë se duke u detyruar të bëjnë kompromise, e ato si duket janë të pashmangshme, do të rrezikohet pushteti i tyre. Nga ana tjetër, marrëveshja politike finale ndikon jo në mobilizim, por në polarizimet e brendshme.

dialogun

Madje, sipas tij, Kosova është dashur më herët ta ketë këtë kushtëzim në bisedat me Serbinë. Maliqi ka vlerësuar se partitë opozitare në vend se të ndërmarin masa obstruktive kundër finales së dialogut që nuk çojnë askund, duhet ta mbështesin këtë proces. Sipas tij, LDK-ja do të bënte mirë nëse do ta ndihmonte dialogun duke u dëshmuar si parti institucionale. Maliqi ka thënë se edhe PSD-ja do të mund të faktorizohej edhe më nëse do të hynte në ekipin e dialogut por, sipas tij, ata janë ende peng të retorikës së trashëguar nga të qenit pjesë e LV-së.

"Epoka e re": Z. Maliqi, meqë dialogu me Serbinë ka hyrë në fazën finale, janë shtuar edhe përpjekjet për arritjen e konsensusit politik për këtë proces. Por, duke pasur parasysh klimën politike, sa ka gjasa që opozita (të paktën LDK-ja) të ndryshojë qëndrim dhe ta përkrahë finalen e dialogut?

Maliqi: Finalen e dialogut e kërkojnë faktorët ndërkombëtarë, kurse Kosova dhe Serbia sikur nuk janë entuziaste. Liderët në Prishtinë dhe Beograd kanë frikë se duke u detyruar të bëjnë kompromise, e ato si duket janë të pashmangshme, do të rrezikohet pushteti i tyre. Nga ana tjetër, marrëveshja politike finale ndikon jo në mobilizim, por në polarizim e brendshme. Opozita edhe në Prishtinë edhe në Beograd paralajmëron se procesi do të përfundojë me humbje. Ne sigurisht nuk brengosemi për përçarjet dhe përçarjet serbe, atyre zakonisht nuk u ka pëlqyer asnjë kompromis rreth Kosovës, as marrëveshja e Rambujes, as Plani i Ahtisarit dhe nuk do t'u pëlqejë as marrëveshja finale. Kurse Kosova deri më tash gjithnjë ka qenë më e mobilizuar me ekipe të unitetit përkrah vendeve perëndimore edhe kur ato propozonin zgjidhje "joperfekte", por që avanconin statusin e Kosovës. Tani për herë të parë sikur kemi të përçarë dhe të pavendosur, larg jo vetëm nga konsensusi, por ndoshta edhe nga shumica e thjeshtë. Opozita aktuale e përbërë nga LDK-ja dhe LV-ja po ndërmerin masa obstruktive kundër finales së dialogut që s'çojnë askund. Janë disa nisma që po shtrohen vonë, si ajo që dialogun duhet ta udhëheqë Kuvendi e jo presidenti Thaçi, ose kërkojnë rrëzimin e Qeverisë dhe organizmin e zgjedhjeve që, mbase, do ta shpenzonte tërë kohën që është paramenduar për arritjen e marrëveshjes përfundimtare. A është qëllimi që të humbet koha dhe marrëveshja të

shtyhet deri pas vitit 2020? Nga ana tjetër, unë nuk po shoh se LDK-ja dhe LV-ja kanë përputhje strategjike rreth marrëveshjes me Serbinë. Për LV-në e dimë se gjithnjë ka qenë kundër dhe e dëshiron dështimin e dialogut, kurse LDK-ja deri vonë ka qenë pjesë e tij dhe nuk besoj se është për dështimin e tij. Mbase edhe do t'i kthehet tryezës së finales nëse siguron status inferior. Për shembull, që ta ketë rolin e bashkëkryetarit të dialogut.

"Epoka e re": Këto ditë është përfolur shumë në media dhe në opinion mundësia e ndarjes së Kosovës dhe shkëmbimi i territoreve. Parashihni rrezik për një gjë të tillë?

Maliqi: Ky opsion gjithnjë ka qenë i pranishëm në Serbi edhe në vitet '90, edhe tani po përmendet gjithnjë e më shpesh si kapja e trenit të fundit. Për shkëmbimin e territoreve ka pasur ide edhe ndër shqiptarët, sidomos nga liderët dhe popullsia e Luginës së Preshevës. Tani ka zëra që thonë se në mes të Trumpit dhe Putinit ka pasur një marrëveshje për këtë, duke e lidhur edhe me koncesionet e Rosisë rreth Krimesë. Por, nuk më besohet se kjo mund të ndodhë vetëm me një marrëveshje të tillë. Çështja është shumë më e komplikuar pasi që do të shërbente si precedent për konflikte të ngjashme territoriale gjithandej globit. Ajo çfarë mund të ndodhë pa këto komplikime është që Serbia dhe Kosova paraprakisht ta njohin njëra-tjetrën si shtete të pavarura, pastaj të bëhet shkëmbimi i territoreve në kuadër të përcaktimit të demarkacionit mes dy shteteve. Përndryshe, Kosova si edhe shtetet e tjera të dala nga shkatërrimi i ish-Jugosllavisë i ka kufijtë çfarë kanë qenë në ish-federatën jugosllave.

"Epoka e re": Presidenti ka paralajmëruar se pjesë e fazës finale do të jetë edhe mbrojtja dhe avancimi i të drejtave të shqiptarëve të Luginës së Preshevës. A mund të sjellë

dialogu rezultate në këtë drejtim, apo Serbia nuk do të pranojë fare të diskutojë për këtë çështje?

Maliqi: Mund të jetë prelud për inkuadrimin e çështjes së shkëmbimit të territoreve, por më parë është thjesht kushtëzim i Kosovës që t'i zvogëlojë ambiciet e Serbisë rreth Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Beogradi nuk mund të kërkojë autonomi për Asociacionin nëse nuk u jep shqiptarëve të Luginës të drejta dhe status të njëjtë. Nuk di pse më herët nuk e ka pasur Kosova këtë kushtëzim në bisedat me Serbinë.

"Epoka e re": Çfarë do të fitojë apo çfarë do të humbë Kosova me përfundimin e dialogut me Serbinë? Cili do të jetë bilanci i Kosovës nga ky proces?

Maliqi: Nëse gjithçka do të zhvillohet sipas parashikimeve optimiste, Kosova do të sigurojë njohje të pavarësisë nga Serbia, çfarë nënkupton edhe ulësen në Kombet e Bashkuara. Rreth kësaj besoj se nuk do të mund të bëhet kompromis, për shembull, që Kosovës t'i garantohet statusi i shtetit vëzhgues në OKB. Ky status vëzhgues gjithsesi do të ishte një avancim dhe futja e një këmbe në OKB, por atje do të mund të mbeteshim zhag për shumë kohë. Por, ka edhe versione të tjera jo aq të volitshme. Një prej tyre është që të mos ketë marrëveshje dhe do të mbeteshim në një limbo edhe më të pasigurt se ç'jemi tani, një çështje e ngrirë dhe konflikt objektivisht i ngrirë deri te një krizë e madhe evropiane ose botërore.

"Epoka e re": Si e komentoni funksionimin e koalicionit qeverisës? Së fundi, përveç mungesës së kuorumit, opozita ka filluar edhe të mos i votojë marrëveshjet ndërkombëtare nga të cilat Kosova fiton miliona euro. Edhe sa do të mund të ketë jetëgjatësi kjo Qeveri?

Maliqi: Kjo Qeveri e ka gjetur modusin e mbijetesës në faktin se opozita nuk po mund t'i

mbledhë votat për mocion të mosbesimit. Opozita ka hapësirë të vogël manovruese sepse nuk ka ofertë të prekshme dhe premtuese për partnerë koalicioni as me LV-në e as disa parti që janë tani në pushtet dhe do të mund të aspironin më shumë në një qeveri tjetër. Ashtu sikur që kemi pasur bllokadën e mungesës së numrave dhe alternativave në vitet 2014-2015, tani kemi një bllokadë të numrave brenda Kuvendit që nuk mund të zbërthehet lehtë, edhe për shkakun se e kaluara e ka djegur besimin mes shumë partive dhe ato nuk po llogarisin në kombinime të reja të koalicioneve. Duhet pritur zgjedhjet e reja të përgjithshme për të parë nëse ka ndryshime në raportet mes subjekteve politike dhe a ka ndonjë forcë të re që mund të ribalancojë garën për pushtet. Partia e re e vjetër socialdemokrate ka ndoshta potencialin që ta ndryshojë lojën, por pasi që është ndarë nga LV-ja, ende nuk është as vetë e sigurt se mund ta kalojë pragun dhe nuk po gjen as partnerin me të cilin do të mund ta bënte koalicionin paraelektoral. PSD-ja do të mund të faktorizohej edhe më nëse do të hynte në ekipin e dialogut, sado i gjymtë që do të ishte në krahasim me ekipin e synuar të unitetit. Por, ata janë ende peng të retorikës së trashëguar nga të qenit pjesë e LV-së.

"Epoka e re": Z. Maliqi, mund të presim ndonjë iniciativë serioze nga opozita për rrëzimin e Qeverisë, apo do të kemi vetëm deklarata politike?

Maliqi: Derisa janë të vetëdijshëm se nuk i kanë votat për rrëzimin e Qeverisë më shumë bëhet fjalë për retorikë. Po kështu, ndoshta edhe i frikësohen pushtetit në këtë periudhë kur pritet që të aktivizohet Gjykata Speciale dhe të arrihet marrëveshja gjithëpërfshirëse me Serbinë. LDK-ja do të bënte mirë nëse do ta ndihmonte procesin e dialogut duke u dëshmuar si parti institucionale.

Rritet numri i të interesuarve për pasaporta biometrike

PRISHTINË, 29 KORRIK - Pas lajmit për rekomandim pozitiv për liberalizimin e vizave për Kosovën, sipas Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës, është rritur numri i të interesuarve për pajisje me pasaporta biometrike. Deri më tani, sipas kësaj ministrie, mbi 980 mijë persona janë pajisur me këto dokumente. Por, qytetarët nuk janë shumë optimistë se liberalizimi i vizave do të bëhet shpejt.

Në një përgjigje me shkrim për "Radio Kosovën" Zyra për Informim e Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) ka bërë me dije se për momentin



ka shtim të kërkesave për pajisje me pasaporta. Kjo ministri ka theksuar se një gjë e tillë është duke ndodhur edhe për shkak të mërgimtarëve. Por, sipas statistikave të kësaj ministrie, deri më tani 984 mijë e 973 qytetarë janë pajisur me

pasaporta biometrike, ndërsa janë edhe mbi 465 mijë me pasaporta jobiometrike.

Ndërsa qytetarët nuk tregojnë ndonjë interesim të shtuar pas lajmit për rekomandim pozitiv për vizat. Disa prej tyre nuk janë shumë optimistë se kjo mund të ndodhë së shpejti. Por, ka edhe të atillë që rekomandimi për lëvizje të lirë ka ndikuar ta ndërrojnë pasaportën. Zyra për informim e Ministrisë së Punëve të Brendshme ka thënë se nuk ka vonesa gjatë këtyre procedurave dhe çdo pasaportë apo dokument tjetër realizohet brenda afateve ligjore.

Opozita edhe në Prishtinë edhe në Beograd paralajmëron se procesi do të përfundojë me humbje", është shprehur Maliqi.

Ai ka thënë se përfshirja e Luginës së Preshevës në dialog mund të jetë kushtëzim i Kosovës që t'i zvogëlojë ambiciet e Serbisë rreth Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Në këtë kontekst, Maliqi ka theksuar se Beogradi nuk mund të kërkojë autonomi për Asociacionin nëse nuk u jep shqiptarëve të Luginës të drejta dhe status të njëjtë.

Berisha: Misioni i FSK-së të ndryshohet me ligj



PRISHTINË, 29 KORRIK - Transformimi i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në ushtrinë e ardhshme të vendit po i krijon probleme edhe Qeverisë aktuale. Ndonëse u premtua edhe nga vetë kryeministri Ramush Haradinaj, se Kosova do të bëhet me ushtri brenda vitit, ky premtime duket i parealizueshëm, ngaqë Qeverisë po i del pengesë me partnerin e koalicionit, Listën Serbe, që për çështje madhore merr urdhra nga Beogradi. Ndryshimet kushtetuese janë të domosdoshme që FSK-ja nga një forcë e reagimeve emergjente të shndërrohet në një forcë me kapacitete dhe mision ushtarak apo mbrojtës. Por, këto ndryshime aktualisht po i mbajnë peng deputetët e Listës Serbe, pa shumicën e

votave të cilëve, amendamentimet kushtetuese janë të pamundshme. Për këtë çështje ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Rrustem Berisha, i ka thënë "Ekonomia Online" se nuk ka pranuar ndonjë kërkesë zyrtare. Madje ai ka mohuar zërat që kanë qarkulluar rreth mundësisë që veriut t'i jepet një batalion i veçantë, në këmbim të votës së Listës Serbe për ndryshimet kushtetuese. Ai është shprehur se praktika të tilla janë të papranueshme edhe në ushtritë e vendeve të tjera. "Unë deri më tani nuk kam ndonjë kërkesë të tillë, megjithëse opinioni mund të jetë edhe i natyrës së tillë, por ne e kemi një program strategji mbi bazën e së cilës e bëjmë zhvillimin e FSK-së dhe prakti-

ka të tilla edhe në ushtri të tjera janë të papranueshme. Nuk mendoj se diçka të tillë duhet të ketë dhe që është në interes të qytetarëve të Kosovës. Pra, batalionet e tilla edhe në praktikë të ushtrive të rajonit nuk praktikohen", ka thënë Berisha. Ai vlerëson se duhet të shikohen mundësitë që ushtria të formohet përmes ndryshimit të misionit me anë të ligjit sepse, sipas tij, ndryshimet kushtetuese janë të nevojshme vetëm për ndryshimin e emërimit të forcës. "Misioni i FSK-së ndryshohet me ligj, ndërsa me ndryshimet kushtetuese ndryshohet vetëm emri i FSK-së dhe arrihet ajo mbështetja e komuniteteve joshumicë. Si në opsionin A, si në opsionin B, misioni ndryshohet me ligj", ka thënë ministri Berisha.

Universiteti i Prishtinës vazhdon të mbetet lider i universiteteve shqipfolëse

#	Institucioni	2014	2015	2016	2017	2018	Progresi 2014-2018
1	Uni. i Prishtinës	4937	4096	3878	3938	3133	+1804
2	Kolegji AAB - Prishtinë	13949	21101	10358	7308	4603	+9346
3	Uni. i Tiranës	6247	6184	5804	6260	5440	+807
4	Uni. Epoka - Tiranë	5700	5500	5100	5759	6217	-517
5	Uni. i Europës Juglindore	7070	7840	7741	4618	7751	-681
6	Uni. Shtetërorë i Tetovës	11334	8680	8149	6762	11467	-133
7	Uni. Politeknik i Tiranës	8716	7452	7219	6291	11519	-2803
8	Kolegji UBT - Prishtinë	11513	12611	12838	15449	11932	-419
9	Kol. Universum - Prishtinë	15948	17801	17167	13175	13047	+2901
10	Uni. Bujqësor i Tiranës	5142	5142	5142	5444	13149	-8007
11	Uni. i Shkodrës	10132	12527	12506	14864	13355	-3223
12	Uni. European i Tiranës	15145	15455	15297	12514	13659	+1486
13	Uni. i Prizrenit	21096	23113	23856	14590	16257	+4839
14	Kolegji Iliria - Prishtinë	11687	15365	15314	16734	17729	-6042
15	Uni. i Mitrovçës	16897	16897	16897	14909	18018	-1121



PRISHTINË, 29 KORRIK (ER) - Pas publikimit të të dhënave të reja nga "Webometrics Ranking of World Universities" (renditja e Universiteteve Botërore Webometrics) për edicionin e fundit, korrik 2018, Universiteti i

Prishtinës "Hasan Prishtina" renditet sërish si universiteti më i mirë nga universitetet shqiptare në rajon. Në radhitjen e fundit të Webometrics, UP është ngritur për mbi 800 vende më lart se në vitin 2017. Me këtë

rast, rektori i UP-së, prof. dr. Marjan Dema, ka uruar dhe falënderuar studentët, pjesëtarët e stafit akademik dhe administrativ, organet drejtuese dhe menaxhuese të UP-së, si dhe partnerët e brendshëm dhe

të jashtëm, të cilët kanë kontribuar për rritjen e cilësisë dhe imazhit të Universitetit të Prishtinës në sferën e arsimit të lartë në botë. Web Ranking ose Webometrics është renditja më e madhe

akademike e institucioneve të arsimit të lartë, e cila realizohet çdo gjashtë muaj për të gjitha universitetet botërore nga Cybometrics Lab (Spanish National Research Council, CSIC).

Në QKUK fillon zëvendësimi i valvuleve të zemrës me valvule biologjike

PRISHTINË, 29 KORRIK (ER) - Ekipi mjekësor i Shërbimit të Kardiokirurgjisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) ka kryer për herë të parë një operacion tek një pacient i moshës 70-vjeçare, i njohur si zëvendësimi i valvulës aortale me valvulë biologjike (bovin biological aortic valve) të krijuar nga perikardi bovin. Operacionet e tilla mundësojnë që pacientet të jetojnë pa terapi anti-koagulantë. Ato zakonisht vendosen tek pacientët të cilët kanë rrezik nga koagulopatit, te femrat e reja të cilat mendojnë të krijojnë familje, te të rinjtë që

dëshirojnë të merren me sport dhe kanë nevojë për ndërrim të valvuleve si dhe te moshat e shtyra (70 vjet e tutje). Pacienti i operuar është liruar në shtëpi në ditën e pestë postoperative dhe është në gjendje të mirë të përgjithshme dhe lokale. Valvulet biologjike janë valvule të krijuara nga indet shtazore (indet e derrit, lopës, kalit). Në këtë rast është zëvendësuar valvula biologjike e krijuar nga perikardi i lopës. Ky operacion është realizuar nga kardiokirurgët dr. Arbër Kutllovci, kardiokirurg dhe dr. Adem Grbolar, kirurg kardio-

vaskular. Për anestezionin është kujdesur dr. Dafina Matoshi, kardio-anesteziologe dhe dr. Diana Avdyli, kardio-anesteziologe, asistuar edhe nga ekipi i instrumentarëve dhe teknikëve të anestezionit. Kardiokirurgjia vazhdon të realizojë operime të komplikuara dhe të shtrenjta, të cilat realizohen në qendrat e mëdha kardiokirurgjike në botë, duke kursyer pacientët që mos të shkojnë jashtë institucioneve publike, por edhe buxhetin e Ministrisë së Shëndetësisë për trajtim jashtë institucioneve publike shëndetësore.



Mbahet meshë për Adem Demaçin në Katedralen "Nënë Tereza"

Imzot Dodë Gjergji: Adem Demaçi e kishte ideal lirinë dhe atdheun

Në Katedralen "Nënë Tereza" në Prishtinë është mbajtur të dielën meshë për Adem Demaçin, veprimtarin politik dhe aktivistin për të drejtat e njeriut, i cili vdiq të enjten në moshën 82-vjeçare. Në fillim të meshës u bënë lutje që shpirti i Demaçit të prehet në paqe. Ipeshkvi i Kosovës, Imzot Dodë Gjergji, ka thënë se Demaçi gjatë gjithë jetës e ka pasur ideal lirinë dhe dashurinë për kombin

EPOKA
ERE

Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 29 KORRIK - Katedralja "Nënë Tereza" në Prishtinë meshën e së dielës ia ka kushtuar veprimtarit të çështjes kombëtare, Adem Demaçi, i cili ka ndërruar jetë në moshën 82-vjeçare. Ipeshkvi i Kosovës, Imzot Dodë Gjergji, ka bërë me dije se një grup besimtarësh kanë kërkuar që kjo meshë t'i kushtohet veprimtarit Adem Demaçi. Ai ka thënë se Adem Demaçi si ideal ka pasur lirinë dhe dashurinë ndaj kombit. "Kisha nuk përton t'i bashkohet lutjes së besimtarëve dhe njerëzve vullnetmirë për shpirtin e një atdhetari, për shpirtin e një njeriu i cili në gjithë jetën e vet e ka pasur ideal lirinë, e ka pasur dashurinë ndaj kombit dhe e ka dëshiruar me gjithë zemër të mirën e të gjithëve në këtë vend. Ai sot nuk është më me ne, iu bashkua një atdheu të ri që është atdheu qiel-

lor, vendi i përbashkët i të gjithëve. I është bashkuar Gjergj Kastriotit Skënderbeut, i është bashkuar të gjithë burrave e grave që kanë sakrifikuar në të kaluarën, u është bashkuar njerëzve që i kemi njohur, Shën Nënë Terezës që ia kemi kushtuar këtë kishë, martirëve të Shqipërisë, imzot Mark Sopit, Ibrahim Rugovës, është bashkuar me Arbën Xhaferin. Është bashkuar me të gjithë njerëzit që kanë kaluar nga kjo jetë në amshim dhe përpara Zotit. Sigurisht e sheh ndryshe botën, e sheh ndryshe jetën, i sheh ndryshe edhe ata me të cilët është bashkuar. Na sheh ndryshe edhe neve nga dritarja e atit tonë qiellor që po lutemi për të", ka thënë ai. Imzot Dodë Gjergji gjatë kësaj meshe ka pasur edhe një porosi, duke thënë se populli i Kosovës sot ka nevojë për ta gëzuar lirinë e vet. "Populli ynë sot ka nevojë që këtë liri të mos e përbuzë, por ta vë në shërbim dhe në dobi të gjener-



atave të reja dhe duhet ta kuptojmë si falënderim ndaj Zotit për të gjithë ato gjenerata që kanë sakrifikuar për liri. Paqja duhet të jetë ushqim i përditshëm për secilin prej nesh, sa shumë kemi nevojë të pajtohemi me njëri-tjetrin, sa shumë ka nevojë njeriu ynë të pajtohet me vetveten. Pa pajtim të sinqertë nuk mund të presim një udhëtim të mirë drejt të ardhmes", ka thënë imzot Dodë Gjergji.

Pjesëmarrës në këtë meshë për veprimtarin Adem Demaçi ishin edhe dy fëmijët e tij, Abetarja dhe Shqiptari. Ata kanë shprehur falënderimet e tyre që kjo meshë e së dielës i është kushtuar shpirtit të babait të tyre. Abetarja Demaçi ka thënë se babai i saj ishte njeri i kombit dhe ka besuar në Zot. "Sot unë dhe vëllai erdhëm për të qenë

Thaçi, mirënjohës ndaj Kishës Katolike që organizoi meshë për Demaçin

Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, i ka shprehur mirënjohje Kishës Katolike për organizimin e meshës për veprimtarin e çështjes kombëtare, Adem Demaçi, i cili ndërroi jetë më 26 korrik. Thaçi përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se Demaçi ishte njeri i drejtpërdrejtë, tolerant e mendjehapur. "Mirënjohës për Kishën Katolike, për organizimin e meshës për shpirtin e veprimtarit, Adem Demaçi. Ai ishte i drejtpërdrejtë, tolerant, mendjehapur, kampion i fjalës së lirë. Dritë pastë shpirti i tij!", ka shkruar Thaçi.

pjesëmarrës në këtë meshë e cila ishte e mrekullueshme dhe shumë e organizuar. Ne ishim shumë të lumtur që kemi qenë pjesëmarrës në këtë meshë për hir të babait tonë, Adem Demaçit. I falënderojmë shumë për këtë

shërbesë", ka thënë ajo.

Adem Demaçi, veprimtar politik dhe mbrojtës i të drejtave të njeriut, njihet si simbol i rezistencës në Kosovë për lirinë dhe pavarësinë e saj. Për shkak të pikëpamjeve të tij politike, ai kishte vuajtur dënim prej 28 vjetësh në burgjet e ish-Jugosllavisë, më pas të Serbisë, andaj shpesh është quajtur "Mandela i Ballkanit". Adem Demaçi ndërroi jetë në moshën 82-vjeçare, të enjten në Prishtinë. Ai u varros të shtunën me nderimet më të larta shtetërore në Varrezat e Dëshmorëve në Prishtinë.

UP-ja sot mban mbledhje përkujtimore për Demaçin

Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" ka njoftuar se sot (e hënë) do të mbajë një mbledhje përkujtimore kushtuar veprimtarit të çështjes kombëtare, Adem Demaçi, i cili ka ndërruar jetë më 26 korrik. Mbledhja përkujtimore do të mbahet në orën 12:00 në sallën e Senatit në Rektorat.



Zëvendësministri i FSK-së: Idetë mbi ndarje territoriale u takojnë mendësive të kaluara

PRISHTINË, 29 KORRIK (ER) - Zëvendësministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), Burim Ramadani, ka thënë se idetë për shkëmbim terri-torësh në mes të Kosovës dhe Serbisë u takojnë mendësive të kaluara. Ai në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se Kosova nuk ka nevojë për ide të tilla. "Zgjidhjet e konflikteve përmes metodave johumane

janë tragjike. Janë dëshmuar si të tilla në rajone të ndryshme gjithkrah nëpër botë. Kosova është pajtuar dhe implementon me sukses të dukshëm modelin e demokracisë pushtetndarëse (modelin e teorizuar nga Arendt Lijphart në vitet '60). Ky model funksionon në bazë të përfaqësimit joproporcional të komuniteteve pakicë. Secili model tjetër (shkëmbim terri-

toresh, ndarje territoriale, deportimi, hegjemonia, federalizmi apo të tjera) është më pak demokratik dhe shkelë të drejtat e liritë themelore të njeriut. Prandaj, Kosova s'ka nevojë fare për ide rreth modeleve të tjera. Kosova vetëm duhet të njihet kështu si shtet, që ekziston. Sepse, ekziston. Sepse, funksionon. Asgjë më pak!", ka shkruar Ramadani.



Arifi-Krasniqi: Depozitat në Kosovë janë të siguruara

Drejtoresha menaxhuese e Fondit për Sigurimin e Depozitave në Kosovë, Violeta Arifi-Krasniqi, ka thënë se depozitat në Kosovë, bazuar në kompetencat ligjore që ka FSDK-ja, janë të siguruara në rast të revokimit të licencës së ndonjë banke nga BQK-ja. Sipas saj, Fondi i Sigurimit të Depozitave ka arritur shumën 36 milionë euro pas pranimit të rregullt të premive të vazhdueshme të sigurimit nga bankat anëtare si burim kryesor i financimit

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 29 KORRIK - Drejtoresha menaxhuese e Fondit për Sigurimin e Depozitave në Kosovë (FSDK), Violeta Arifi-Krasniqi, ka thënë se mandati kryesor i institucionit që drejton është sigurimi i depozitave të personave fizikë dhe juridikë në bankat anëtare dhe kompensimi i depozitorëve të siguar deri në limitin e sigurimit prej 5 000 eurosh brenda tridhjetë (30) ditëve në rast revokimit të licencës së ndonjë banke nga BQK-ja, sipas kriteve dhe limiteve të përcaktuara në LSD. "FSDK-ja ka mandat të caktimit dhe arkëtimin të premive të sigurimit, investimit të fondit për sigurim të depozitave në bashkëpunimin me Bankën Qendrore të Kosovës për shkëmbim të informacionit, pjesëmarrjen me fonde, në bashkëpunim me BQK-në për zgjidhje të ndonjë banke anëtare në rast të transferimit të detyrimeve të siguruara, huamarrjen në rast të pamjaftueshmërisë së fondeve si dhe miratimin e legjislacionit sekondar dhe sanksioneve administrative", ka treguar Arifi-Krasniqi për gazetën "Epoka e re".

Ajo ka bërë me dije se më 30 qershor të këtij viti Fondi i Sigurimit të Depozitave ka arritur shumën prej 36 milionë eurosh pas pranimit të rregullt të premive të vazhdueshme të sigurimit nga bankat anëtare si burim kryesor i financimit. Arifi-Krasniqi ka thënë se sistemi i sigurimit të depozitave në Kosovë është iniciuar si projekt zhvillimor nga BQK-ja me mbështetje të plotë nga Qeveria gjermane (përmes KfW-së) që nga viti 2007. "Fillimisht është përkrahur hartimi i Ligjit për Sigurimin e Depozitave, ndërsa

mbështetja për themelimin e SSD-së u formalizua me nënshkrimin e marrëveshjes trepalëshe të financimit dhe projektit në mes të Qeverisë së Kosovës (përmes MF), Qeverisë gjermane (përmes KfW-së) dhe FSDK-së në vitin 2012. Marrëveshja ka paraparë mbështetjen për themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave në Kosovë përmes një kontributi në kapital si donacion për FSD-në në shumën totale prej 15.5 milionë eurosh, ku 11 milionë euro janë dhënë nga Qeveria e Kosovës (përmes MF), ndërsa Qeveria gjermane (përmes KfW) që ka siguruar 4.5 milionë euro kontribut në kapital dhe 0.5 milion euro në shërbime këshillimore", ka thënë ajo.

Arifi-Krasniqi ka pohuar se si rezultat i suksesit të projektit fillestar është nënshkruar marrëveshja e dytë e financimit dhe projektit, në vitin 2013, me donacion në vlerë prej 2 milionë eurosh. "Kjo marrëveshje është nënshkruar nga Qeveria e Kosovës përmes Ministrisë së Financave, Qeverisë gjermane (përmes KfW) dhe FSDK, për mbështetjen e rritjes së limitit të sigurimit nëpër faza: 3 000 euro (1. 1. 2014), 4 000 euro (1. 1. 2016) dhe 5 000 euro (1. 1. 2018)", ka deklaruar Arifi-Krasniqi.

Ajo ka shtuar se deri më 31 mars 2018 totali i depozitave arriti në tre miliardë euro, ndërsa totali i depozitave të siguruara deri në limitin e sigurimit prej 5 000 euro ishte 727 milionë euro. "Ngjashëm me trendet e viteve të kaluara, raportojmë rritjen e vazhdueshme të totalit të depozitave dhe atyre të siguruara. Kështu, më 31 mars 2018 totali i depozitave arriti në tre miliardë euro, ndërsa totali i depozitave të siguruara deri në limitin e sigurimit prej 5 000

eurosh ishte 727 milionë euro, ose 24 për qind të gjithsejtë depozitave në bankat anëtare. Gjithsejtë numri i depozituesve të siguar, pra personave fizikë dhe juridikë, ishte 921,474 apo 98.6 për qind të numrit të përgjithshëm të depozituesve të

bankave anëtare. Numri i depozituesve të cilët janë të mbuluar plotësisht deri në limitin e sigurimit të depozitave ishte 88.56 për qind, që do të thotë se 837 253 e depozituesve të siguar kanë depozita deri në 5 000 euro. Përderisa 84 221

depozituesve të siguar apo 9.01 për qind, kanë depozita më shumë se 5 000 euro. Ndërkaq, që nga themelimi i FSDK-së e deri më tani nuk ka pasur raste të mbylljes së ndonjë banke, prandaj edhe Fondi i FSDK-së nuk është aktivizuar për



FSDK-ja ka hartuar udhëzuesin për depozitorët mbi procesin e kompensimit të depozitave

Drejtoresha menaxhuese e FSDK-së, Violeta Arifi-Krasniqi, ka thënë se FSDK-ja ka hartuar udhëzuesin për depozitorët mbi procesin e kompensimit të depozitave të siguruara. "FSDK-ja do ta fillojë procesin e kompensimit menjëherë pas pranimit të vendimit nga BQK-ja për revokimin e licencës dhe fillimit të likuidimit të ndonjë banke anëtare, që në terminologjinë e sigurimit të depozitave njihet si 'ngjarje e siguruar'. Afati kohor për kompensimin e depozitorëve deri në limitin e sigurimit prej 5 000 eurosh (në fuqi nga 1. 1. 2018) do të bëhet brenda 30 ditëve, me paraqitjen e dëshmisë së pronësisë dhe të identitetit nga ana e depozitorëve në mënyrë që ta pranojnë shumën e siguruar. Për të siguruar kompensim të shpejtë të depozitorëve, FSDK-ja do ta angazhojë Bankën Agjente për Pagesë (BAP) për rimbursim të shumës së kompensimit për depozitorët. BAP janë bankë(a) anëtare, që përmëshin kriteret procedurale të BQK-së dhe që kanë aftësi

operacionale dhe organizative për ta ekzekutuar procesin e kompensimit në emër dhe për FSDK-në", ka thënë ajo. Sipas Arifi-Krasniqit, afati kohor maksimal i lejuar për depozitorët që të realizojnë të drejtën e marrjes së shumës së kompensimit është dy vjet pas shpalljes së njoftimit në lidhje me procesin e kompensimit. "Pas këtij afati, depozitorët do ta humbasin të drejtën e tyre për ta marrë shumën dhe shumën e mbetur e depozitave do t'i kthehet FSDK-së për përdorim në rastet e ardhshme të kompensimit. Është me rëndësi të ceket për depozitat që tejkalojnë shumën e siguruar prej 5 000 eurosh, depozitorët këshillohen të kontaktojnë likuidatorin e bankës së cilës i është revokuar licenca për ta bërë kërkesën në lidhje me depozitat e tyre të pasiguruara në pajtim me procedurat e likuidimit siç përkufizohet në Ligjin për Bankat. FSDK, që nga themelimi, nga viti 2011 e deri më sot, nuk ka pasur raste të kompensimit", është shprehur Arifi-Krasniqi.

humbja në rast të revokimit të licencës të ndonjë banke dhe mbështetjen e BQK-së për arritjen e qëllimit të saj për rritjen e sigurisë. "FSDK është themeluar me Ligjin për Sigurimin e Depozitave për ta administruar Sistemin e Sigurimit të Depozitave në Kosovë. Sistemet e sigurimit të depozitave janë ndër shtyllat e rritjes së sigurisë financiare, si rregullativës procedurale dhe mbikëqyrjes efektive, kreditorit të instancës së fundit, si dhe mekanizmave efektive të zgjidhjes së bankave. Sistemi i Sigurimit të Depozitave në Kosovë është themeluar për t'i përmëshur dy qëllime të politikës publike: mbrojtjen e depozitorëve të vegjël nga humbja në rast të revokimit të licencës të ndonjë banke dhe mbështetjen e BQK-së në arritjen e qëllimit të saj për rritjen e sigurisë, solvencës dhe funksionimit efikas të një sistemi stabil, të bazuar në ekonominë e tregut", është shprehur Arifi-Krasniqi.

Ajo ka deklaruar se depozitorët nuk kanë asnjë detyrim të përmëshjes për të qenë të siguruar për depozitat tyre, pasi bankat janë anëtare të FSDK-së. "Depozitorët s'kanë asnjë

detyrim përmëshjeje për të qenë të siguruar nga Sistemi i Sigurimit të Depozitave në Kosovë, mjafton që të kenë një llogari bankare në ndonjërin bankë anëtare të FSDK-së. Sigurimi i depozitorëve vjen si rezultat i marrëdhënies kontraktuale në mes të depozitorit dhe bankave për llogaritë depozituese. Bankat janë anëtare të detyrueshme të FSDK-së dhe ky anëtarësim në sistemin e sigurimit të depozitave është automatik me rastin e licencimit nga BQK-ja. Prandaj, FSDK-ja siguron çdo person fizik dhe juridik që ka të deponuara para në bankat anëtare deri në limitin e sigurimit prej 5 000 eurosh. Sigurimi vlen në nivel të depozitorit për çdo bankë anëtare të FSDK-së. FSDK siguron personat fizikë dhe juridikë ndaras, deri në limitin e sigurimit prej 5 000 eurosh. Si shembull, nëse depozituesi ka dy llogari në të njëjtën bankë si 'person fizik' dhe 'person juridik' atëherë, në rast të tillë, depozitat e personit fizik dhe të personit juridik sigurohen ndaras, përkatësisht deri në 5 000 uro 'si person fizik' dhe deri në 5 000 euro 'si person juridik', ka thënë ajo.

Para të falsifikuara në tregun e Kosovës

PRISHTINË, 29 KORRIK - Vetëm brenda gjashtë muajve të këtij viti në Policinë e Kosovës janë raportuar mbi 250 raste të parave të falsifikuara, derisa në vitin e kaluar të raportuara kanë qenë afro 800 raste. Sipas të dhënave të Policisë së Kosovës, vetëm në një rast në vitin 2017 ishin konfiskuar mbi dy milionë euro para të falsifikuara. Për sa iu përket masave kundër falsifikimit, Banka Qendrore e Kosovës (BQK) vazhdon të bashkëpunojë me autoritetet për avancimin e raportimit të parave të gatshme të dyshuara si false.

Kushtrim Ahmeti, zëdhënës në BQK, në një prononcim për "Radion Evropa e Lirë" ka theksuar se lufta kundër parasë së falsifikuar është një aktivitet i përditshëm i të gjitha institucioneve përgjegjëse, duke përfshirë këtu edhe institucionet financiare të licencuara nga Banka Qendrore që veprojnë në Kosovë. "Bazuar në raportet e pranuar nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë, në vitin 2017 kemi pasur rritje prej 89 përqindësh të numrit të parave të falsifikuara të tërhequra nga qarkullimi. Numri i këtyre kartëmonedhave ishte 1 557, kurse shumën e tyre ishte mbi 100 mijë euro", ka thënë Ahmeti.

Ai ka shtuar se pjesa më e madhe e këtyre kartëmonedhave janë konfiskuar nga institucionet financiare gjatë aktivitetit të tyre të rregullt. Ndërsa, sipas tij, kartëmonedha më e falsifikuar në vitin 2017 kanë qenë kartëmonedha prej 100 eurosh. "Për dallim nga vitet paraprake, ku kartëmonedhat më të falsifikuara kanë qenë kartëmonedha në prerje prej 50 eurosh dhe 20 eurosh, gjatë vitit 2017 kartëmonedhat më të falsifikuara kanë qenë kartëmonedhat në prerje prej 100 eurosh dhe 50 eurosh. Denominimet në

vlerë prej 20 eurosh përbënin rreth 13 për qind të gjithë numrit të kartëmonedhave të falsifikuara gjatë vitit 2017. Pjesa tjetër e denominimeve ishin kryesisht të denominimeve prej 10 eurosh dhe 5 eurosh", ka bërë me dije Ahmeti.

Sipas Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, kartëmonedhat dhe monedhat e paraqitura tek institucionet financiare, që dyshohen të jenë false, duhet të nxirren nga qarkullimi dhe menjëherë t'u dërgohen autoriteteve të caktuara. Ndërkohë, sipas ekspertëve të çështjeve ekonomike, vënia e parave të falsifikuara në qarkullim ka efekte negative në ekonominë e një vendi. Por, për t'u ikur parave të falsifikuara, eksperti i çështjeve financiare, Milazim Abazi, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se qytetarët duhet t'i reduktojnë transaksionet me para të gatshme dhe çdo gjë të bëhet përmes kartelave bankare. "Paratë e falsifikuara në treg krijojnë pasiguri te qytetarët dhe gjithsesi është e dëmshme për ekonominë e një vendi. Kjo duhet t'i vetëdijesojë qytetarët që sa më pak t'i përdorin paratë 'cash' dhe t'i përdorin mjetet e tjera të pagesës, siç janë kartelat bankare. Kjo është e mirë e shumëfishtë dhe është më e sigurt dhe ndihmon në luftimin e informalitetit dhe krimin që bëhet përmes parave", ka thënë Abazi.

Që nga janari i vitit 2012, Kosova kishte konvertuar valutën nga valuta gjermane marka në valutën euro. Në atë kohë Banka Qendrore e Kosovës, në bashkëpunim me Policinë, bën angazhime të veçanta në fushën e edukimit dhe luftimit të parave fals, si dhe themeluan Komitetin Kombëtar për Luftimin e Parave Fals.



pagesën e depozitorëve", është shprehur ajo.

Arifi-Krasniqi ka thënë se sistemi i Sigurimit të Depozitave në Kosovë është themeluar për të përmëshur dy qëllime të politikës publike, si mbrojtje e depozitarëve të vegjël nga

Këndvështrim

Libër me një larushi të pasur tematike


Avni Shaqiri, "Dhelpra në banketin e pulave" (poezi për fëmijë e të rinj)

Bilall MALIQI

Para nesh kemi një libër simpatik, të dashur dhe tërheqës për lexim. Fjala është për vëllimin poetik për fëmijë me titull "Dhelpra në banketin e pulave" të poetit Avni Shaqiri. Poeti Shaqiri në opinionin art-dashës njihet si poet që shkruan për të rritur, por edhe për fëmijë, ku në poezitë e tij gjejmë vend motive të larmishme, posi ngjyrat e ylberit, të cilat i shpërndan gjithandë përmbledhjeve të tij poetike, e të tilla motive e rrumbullakojnë edhe këtë libër. Poeti shumë mirë e din se fëmija dëshiron shumë nga poeti, ai nuk kënaqet me pak, do të ketë brenda vargjeve poetike, lojë, satirë, pra fëmijët duan të bëhen pjesë e këngëtimit poetik të autorit. Edhe në këtë libër poeti fëmijëve u ka servuar vargje domethënëse dhe poezi, të cilat për një kohë të gjatë do të ngelen në mbamendjet e tyre, si poezi që ngjallin kureshtje për t'i lexuar. Motivet që janë brenda kopertinave të librit janë nga më të ndryshmet, si patriotike, sociale, kurbetit dhe të bëmat e përditshmërive tona në rrafshin jetësor, të cilat ka ditur t'i mbarështrijë nëpër poezitë prezentë në libër. Autori me anë të botës shtazore, me rolet që iu ka dhënë nëpër poezitë e librit, identifikon të

gjitha parregullsitë apo të gjitha padrejtësitë që iu kanë bërë dhe po i bëhen akoma popullit shqiptar në këtë nënqiell që flet shqip. Disa nga poezitë janë të karakterit edukativ e moralizues, të cilat do të ndikojnë që fëmijët t'i lënë veset negative, të cilat mund t'i kenë, dhe të bëhen të mbarë, zatën dhe ky është misioni i një krijuesi që shkruan për fëmijë, por jo vetëm për fëmijë, poezitë të përçojnë mesazh të qartë për secilën shtresë të lexuesve. Kur jemi tek motivi patriotik, të cilin poeti Shaqiri, e rrahë shumë mirë, para nesh na del një pasqyrë shumë reale e ndodhjeve nëpër kohë dhe situata të ndryshme, të cilat kanë qenë dhe janë evidente edhe për autorin e librit.

Atij (autorit) i dhemb në shpirt çështja e pazgjidhur shqiptare, pra është një protestues i vargëzuar karshi këtyre padrejtësive të panumërta që e përthekojnë popullatën e kësaj Krahine dhe më gjerë. Brenda vargjeve të librit gjejmë edhe një dozë humori apo satire, sepse kjo grupmoshë e lexuesve gjatë leximit të disa poezive më këtë karakter, fitojnë çlodhje dhe dëfrim. Poezitë e librit janë të drejtpërdrejta, pa ndonjë hermetizëm, kanë rimën, muzikalitetin, vargjet e poezive korrespondojnë lirshëm në mes veti dhe janë



shumë të kapshme për imajinatën e kësaj pjese të shtresës së lexuesve. Shumica sosh e poezive janë të gjata me strofa katrena, nuk janë të rënduara me fjalë të tepërta, porse janë të kuptueshme dhe të dashura për t'i lexuar dhe riletuar për shumë herë. Librat me poezi dhe me tregime për fëmijë janë deficitare, edhe krijuesit që merren me këtë ligjërim, janë po ashtu deficitar, andaj edhe ky libër me poezi nga më të ndryshmet, dedikuar kësaj shtrese të lexuesve, janë të mirëseardhura, sepse të shkru-

ash për fëmijë nuk është edhe aq lehtë, duhet ta marrësh edhe rolin e të qenit fëmijë, të luash me ta lojëra të ndryshme, të këndosh me ta, në mënyrë që ta arrijë me anë të vargjeve kërkshërinë e lexuesve të vegjël. Poezitë e këtij libri shumë lehtë mund të mësohen përmendësh dhe të recitohen nëpër gara të recituesve. Poezitë prezente janë të pajisura edhe me figura stilistike, e figura më e pranishme nëpër poezitë e këtij libri, është ajo e krahasimit, të cilat ia rrisin vlerën ideo-artistike librit.

Marrë në përgjithësi kjo përmbledhje poezish për fëmijë e poetit Avni Shaqiri, shoqërohet me vlera të begatshme artistike, duke iu sugjeruar lexuesve të vegjël ta marrin e ta lexojnë këtë libër dhe të bëhen pjesë e ngjarjeve, të ndodhjeve poetike të librit, mbase edhe kritika që merret me studimin e librave të ligjërimit poetik për fëmijë së bashku me lexuesit e vegjël ta thonë fjalën e tyre të fundit, për këtë libër, e shpresoj që do ta ndajnë edhe ata të njëjtin mendim, lidhur me vlerat poseduese të kësaj përmbledhje poetike.

Lumbardhi, hapësirë publike për të gjithë

PRIZREN, 29 KORRIK (ER) - Është finalizuar iniciativa "Lumbardhi, hapësirë publike për të gjithë", e konceptuar nga pjesëmarrësit e Shkollës së Aktivizmit Urban në kuadër të projektit "Rikthimi i qytetit". Kjo iniciativë ka për qëllim të kontribuojë në pasurim përmbajtësor të hapësirave të përbashkëta të Kino Lumbardhit përmes bibliotekës së hapur, posterëve informues lidhur me historikun e Lumbardhit si dhe zgjerimin e hapësirave gjelbëruese. "Këta komponentë do ta ndihmojnë hapësirën e përbashkët të Kino Lumbardhit të jetë e përshtatshme për shfrytëzim nga të gjitha grupet e komunitetit, veçanërisht të të rinjve", është bërë me dije në njoftimin e "EC Ma Ndryshe". Ideja për krijimin e një biblioteke të hapur është dhënë



gjatë Moduli 1 të Shkollës së Aktivizmit Urban, të mbajtur në muajt prill-maj të këtij viti, gjatë

së cilës të rinjtë pjesëmarrës të shkollës kanë pasur rastin të aftësohen lidhur me principet e

aktivizmit urban. Ndër të tjera, kjo iniciativë është konceptuar që të ndërlihdë në

vete thirrjen për dhurimin e librave nga ana e qytetarëve, përzgjedhjen e dizajnit të elementeve të shtuara në hapësirat e Lumbardhit si dhe përzgjedhjen e posterëve informues. Gjatë thirrjes së hapur për dhurimin e librave, qytetarët me vullnetin e tyre për ta pasuruar bibliotekën e Kino Lumbardhit dhe për ta ndihmuar realizimin e kësaj iniciative të buruar nga nxënësit e ShAU, kanë arritur të grumbullojnë 116 tituj. Librat e dhuruar u takojnë disiplinave të ndryshme, përfshirë këtu sociologjinë, historinë, gjeografinë, psikologjinë, teologjinë, artin bashkëkohor, arkitekturën etj. Projekti "Rikthimi i qytetit - e drejta mbi qytetin për grupet e nënperfaqësuar të komunitetit në Prizren" përkrahët financiarisht nga National Endowment for Democracy.

Brenda 24 orëve policia shqiptoi 1 652 gjoba trafik

PRISHTINË, 29 KORRIK - Policia e Kosovës (PK) brenda 24 orëve ka shqiptuar 1 652 gjoba

kundër ngasësve të automjeteve të cilët nuk kanë respektuar shenjat e komu-

nikacionit. Siç ka njoftuar Policia e Kosovës, kanë ndodhur gjithsej 70 aksidente, prej

tyre 17 kanë përfunduar me të lënduar, kurse 53 pa të lënduar.



MANDATI I TIJ, MANDAT I GJITHËKOHSHËM

Rexhep QOSJA

Adem Demaçi, Baca Adem, u nda nga jeta.

Ndarja e tij nga jeta pikëlloi gjithë shqiptarët kudoqofshin ata.

Adem Demaçi ishte dhe mbetet Baca Adem, i gjithëkohshëm në historinë e popullit shqiptar: i gjithëkohshëm me Emrin e tij, me veprën e tij, me lavdinë e tij. Në jetën dhe në historinë e popullit shqiptar ai ishte i veçantë me çdo gjë e me të gjitha.

Ai e jetonte Idealin e tij; ai e jetonte Fjalën e tij; ai e jetonte gjithë Veprën e tij.

Ideali i tij, fjala e tij ishte, është dhe do të jetë përgjithmonë njëkohësisht ideal i kombit shqiptar, fjalë për kombin shqiptar.

Herët, në rini, ai u bë mësuesi historik, politik, kulturor, kombëtar e moral i rinisë shqiptare në Kosovë.

Ai u bë Mësuesi i qëndrimit të drejtë, të papërkulshëm, të dinjitetshëm, që nuk e përkulnin leverditë, premtimet, kërcënimet, burgjet.

Ai u bë parathënësi i lirisë dhe i pavarësisë së Kosovës.

Ai u bë parathënësi i bashkimit kombëtar shqiptar.

Idealin e madh të lirisë dhe pavarësisë së Kosovës ai e jetoj me 28 vjet burgje dhe me shumë përndjekje e krajata para dhe pas burgjeve.

Dhe këta 28 vjet burgje dhe këto përndjekje e krajata u bënë dëshmi sipërorë që të gjithëve - bashkëkombësve dhe të huajve - u dëshmonin se Adem Demaçi po ia dhuronte rininë, pjekurinë,

dhuntinë krijuese kësaj lirie dhe pavarësie të Kosovës.

Me këtë sakrificë madhështore historike ai e dëshmoi burrërinë, vendosmërinë, parimësinë politike e morale edhe kur doli prej burgjeve.

Sot kur Baca Adem u nda prej nesh vetëm me trupin e tij e do rendi të vetëpyetemi: çfarë bëmë ne për të?!

Sot kur u nda vetëm me trup prej nesh e do rendi të vetëpyetemi se çfarë bënë për të ata që e sundojnë politikisht e shtetërisht Kosovën sot?!

Përgjigjet janë dëshpëruese!

Ata që edhe në ditët e luftës çlirimtare e vallëzonin vallen e paqes turpëruese nën dhunën dhe terrorin e regjimit serb i dhuruan Bacës Adem mohime, denoncime, përjashtime, fyerje!

Ata të tjerët që pas luftës e bënë dhe po e bëjnë demokracinë e Kosovës - demokraci rurale e private - e privuan Bacën Adem prej çdo mundësie që të bëhej çka para të gjithëve i takonte të bëhej: që të bëhej i pari i Madh i Kosovës.

Nuk i lejuan të bëhej kryetar i Kosovës; nuk i lejuan të bëhej as kryetar i Kuvendit të Kosovës; nuk i lejuan të bëhej as kryeministër i Kosovës; nuk i lejuan të bëhej as ministër i Kosovës! Prej ish të burgosurve politikë u propozua që të bëhej deputet i Kosovës, por nuk e lejuan kandidimin e tij as për deputet të Kuvendit të Kosovës ata që edhe për kandidime vendosnin!

Popuj të tjerë, me tradita politike, shtetërore e morale, i zgjedhin senatorë apo deputetë të përjetshëm figurat politike me merita të veçanta në historinë



politike, kulturore e qytetërore të tyre.

Politikanët dhe shtetarët e Republikës Jugafrikane e bënë Nelson Mandelën figurë politike e morale botërore, sepse ashtu e meritonte Mandela dhe sepse ashtu e donin interesat politike e shtetërore të asaj Republike.

Por pushtetarët e sotëm të Kosovës nuk i lejuan Adem Demaçit të bëhet as deputet katërvjeçar i Kuvendit të Kosovës! Pse?! Pse e cenuan kështu Adem Demaçin dhe pse e cenuan kështu Republikën e Kosovës?!

Ata që nuk ia lejuan Adem Demaçit as tre minuta fjalë në Kuvendin e Kosovës, ata që e privuan prej të drejtës së tij sipërore që të bëhej çka i takonte të bëhej në Kosovë, u frikësuan prej tij: prej etikës së tij politike e shtetërore, prej burrërisë së tij, prej nderit të tij, prej vendosmërisë së tij, prej parimësisë së tij, prej humanizmit të tij, dhe u frikësuan sepse ai, Baca Adem, nuk do t'i lejonte të bëjnë çka bënë e çka po bëjnë: ai nuk do t'i

lejonte ta zhvatin Kosovën, ai nuk do t'i lejonte t'i plaçkitin pasuritë e përbashkëta të Kosovës, ai nuk do t'i lejonte të bëhen milionerë duke përdorur e shpërdorur siç po i shpërdorin postet politike e shtetërore të Kosovës shtetërisht të privatizuar prej tyre.

Dhe, ai nuk do t'i lejonte t'i sjellin Kosovës aq tragjikomedi politike, ekonomike, diplomatike, kombëtare e ndërkombëtare që po ia sjellin asaj sot!

Por, o çfarë ironie!

Ata që nuk e lejuan të bëhet as kryetar i Kosovës, as kryetar i Kuvendit të Kosovës, as kryeministër i Kosovës, madje as deputet i Kosovës, ata dje mbajtën akademi për të në sallën gati përgjysmë të zbrazët të Kuvendit të Kosovës dhe ata mbajtën fjalime në atë akademi për të.

Ata shpallen tri ditë zie për të.

Sot ata mbajtën edhe një akademi për të që e quajtën ceremoni dhe e mbajtën në sheshin para Teatrit Kombëtar të Kosovës, ku u rreshtuan njëri pas tjetrit në radhë të

parë për ta përdorur lavdinë e Bacës Adem për interesat e tyre pushtetare.

Prehu i qetë në dheun e Kosovës, Bacë i dashur!

I privilegjove për të të nderuar kështu të ndarë nga jeta ata që këtë privilegj në asnjë mënyrë dhe me asgjë nuk e merituan!

Vepra jote mendore e morale, veprimtaria jote politike kombëtare, lavdia jote historike, burrëria jote, ecja jote gjithmonë e dinjitetshme do të edukojnë gjithmonë rininë tonë dhe do ta lëvizin përparueshëm historinë shqiptare.

Ti ishe më shumë se kryetar i Kosovës, ti ishe më shumë se kryetar i Kuvendit të Kosovës, ti ishe më shumë se kryeministër i Kosovës, ti ishe më shumë se ministër i Kosovës, ti ishe më shumë se deputet i Kosovës.

E si të mos ishe! Ti na dhurove si trashëgim mospajtimin me pushtimin, me çdo lloj pushtimi, me çdo lloj pushtimi e nënshtrimi në të cilin ishte dikur Kosova, por ti na dhurove si trashëgim edhe mospajtimin me të gjitha të këqijat që cenojnë interesat e përgjithshme shoqërore:

mospajtimin me korrupsionin, mospajtimin me nepotizmin, mospajtimin me zhvatjen e pasurive të përbashkëta të Kosovës, mospajtimin me gënjeshtat, mashtrimet dhe arrvizimet që e kanë mbuluar sot Kosovën.

Ti ishe dhe mbetesh ndjenja, ndërgjegjja dhe mendja historike në çastet më të vështira të popullit shqiptar.

Mandati yt është mandat i përjetshëm në historinë e gjithë popullit shqiptar.

28 korrik 2018

ADEM DEMAÇI DO TË JETOJË NË KUJTESËN TONË DERISA TË JETOJË KOSOVA

(Fjalë e mbajtur me rastin e varrimit të Bacës Adem Demaçi në Varrezat e Dëshmorëve në Prishtinë, më 27 korrik 2018)

Selatin NOVOSELLA

Baca Adem, më ka ra hise e vështirë që unë të ndahem i fundit nga ti.

Dhimbja jonë e pakufi, Bacë, sot ka emrin e nënës Nazife, e cila të porositi të mos kujdeseshe për të, sepse ajo një ditë do të vdesë, por të veprosh për nënë Shqipërinë, e cila s'vdes kurrë.

Dhembja jonë e madhe, Bacë, sot ka emrin e motrës Ajshe, e cila, siç thotë kënga për motrën e Gjergj Elez Alisë, që për nëntë vjet po ia shëronte plagët vëllait, kurse motra Ajshe për 28 vjet qëndroi para derye të burgjeve të pushtuesit të shqiptarëve të të shihte prapa shtatë drynave.

Dhembja jonë e përhershme, Bacë, sot, ka emrin e gruas Xhemalije, e cila për 28 vjet të pritit duke i kaluar vitet më të mira të jetës pa ty, duke i rritur, edukuar dhe shkolluar dy fëmijët

tuaj të mrekullueshëm.

Dhembja jonë e thellë, Bacë, sot ka emrin e fëmijëve tu, Abetares dhe Shqiptarit, të cilët u rritën me mallin për babanë, duke u takuar me ty herë pas 10 vjetëve, herë pas 15 vjetëve të vuajtjeve tua në burgjet e Jugosllavisë.

Dhimbja jonë, Bacë, sot ka emrin e Prishtinës, ku ti linde më 26 shkurt 1936 dhe ndërrove jetë më 26 korrik 2018, ku është emërtuar një shesh me emrin tënd, i cili do të jetë pjesë e identitetit të kryeqendrës së Republikës së Kosovës.

Dhembja jonë, Bacë, sot ka emrin e Kosovës për lirinë e së cilës flijove rininë, shëndetin, familjen dhe dhuntinë tënde krijuese.

Dhembja e sotme, Bacë, ka emrin e atdheut tonë të shtrenjtë, Shqipërisë, të cilën, me gojën tënde të artë, gjithnjë e quaje nana Shqipni.

Bacë, sot, kur po ndahemi nga ti



e pyesim veten të gjithë:

- Po të mos kishim ty, kush do të na tregonte kur duhej të nisehim në rrugën e lirisë?

- Po të mos kishim ty, kush do të na mësonte, në udhëkryqet e historisë, se nga të ecnim më tutje?

- Po të mos kishim ty, kush do të na hapte shtigjet e mbyllura në rrugën me shumë pengesa?

- Po të mos kishim ty, kush do të

na jepte shembullin se si të silleshim gjatë hetimeve në UDB-së serbojugosllave?

- Po të mos ishe ti, kush do të frymëzonte që, para gjyqeve të pushtuesit, t'i mbronim të drejtat tona të munguara?

Baca ynë i shtrenjtë:

- Ti asnjëherë nuk u ankove.

- Asnjëherë nuk u ndale.

- Asnjëherë nuk heshte.

- Asnjëherë nuk pushove.

- Asnjëherë nuk i ekspozove plagët tua.

- Asnjëherë nuk kërkove të bëhemi dëshmitarë të atyre plagëve.

Baca Adem, sot kur po ndahemi nga ti për të fundit herë, të vetmin ngushëllim e kemi se jetuan në epokën tënde.

Baca Adem, duke ta dhënë lamtumirën e fundit, të gjithë së bashku, ta themi një fjalë nga thellësia e zemrës, e mendjes dhe e shpirtit: faleminderit, Bacë!

Duke u përshëndetur me ty, Bacë, ne shokët tu, bashkëveprimtarët tu, bashkëmendimtarët tu, bashkëvuajtësit tu, bashkudhëtarët tu, e ndiejmë veten se ishim njerëz me shumë fat që ishim me ty dhe pranë teje, në ditë të vështira në rrugën e lirisë dhe bashkimit kombëtar.

Bacë, me zemra të thyera dhe të plagosura, të gjithë së bashku, me një zë, të themi: lavdi jetës dhe veprës tënde dhe lamtumirë!

Erdogani: Në shtator do të mbajmë samit për Sirinë

ANKARA, 29 KORRIK - Turqia planifikon të mbajë samit me Francën, Gjermaninë dhe Rusinë në fillim të shtatorit, për të diskutuar lidhur me konfliktin sirian dhe çështje të tjera rajonale, ka thënë presidenti turk, Recep Tayyip Erdogan.

Në komentet e publikuara nga mediet turke, Erdogan citohet të ketë thënë se ky takim pritet të mbahet në Stamboll më 7 shtator. Megjithatë, lideri turk nuk ka dhënë detaje për çështjet që pritet të jenë në agjendën e këtij takimi, por ai ka thënë se

Turqia do të vazhdojë dialogun me Rusinë edhe përtej këtij takimi.

Qeveritë në Moskë, Paris dhe Berlin ende nuk e kanë konfirmuar mbajtjen e këtij samiti. Rusia së bashku me Iranin, mbështesin presidentin sirian

Bashar al-Assad në luftën shtatëvjeçare në Siri, ku janë vrarë qindra-mija persona dhe miliona të tjerë janë detyruar të largohen nga shtëpitë e tyre. Turqia, Franca dhe Gjermania, në konfliktin sirian mbështesin grupe të ndryshme rebele.



Presidenti Trump dhe zgjedhjet e mesit të mandatit

Sipas anketimeve, demokratët në zgjedhjet e mesmandatit janë në avantazh dhe të dyja partitë pajtohen se presidenti Donald Trump do të jetë tema kryesore e zgjedhjeve të këtij viti



WASHINGTON, 29 KORRIK - Kanë mbetur 100 ditë deri në zgjedhjet e mesit të mandatit në muajin nëntor, kur do të vendoset fati i të dyja dhomave të Kongresit Amerikan. Anketimet u japin avantazh demokratëve dhe të dyja partitë u pajtuan se presidenti Donald Trump do të jetë tema kryesore e zgjedhjeve të këtij viti.

Gjatë një tubimi së fundi në shtetin Montana, presidenti Trump u bëri thirrje mbështetësve të votojnë në masë për t'i ndihmuar kandidatët republikanë në muajin nëntor. "Nuk do të tërhiqemi dhe nuk do të dorëzohemi kurrë. Ne nuk heqim dorë dhe shkojmë drejt fitores", u tha mbështetësve presidenti Trump. Edhe demokratët në opozitë po

zhvillojnë një fushatë intensive në terren për zgjedhjet e mesmandatit. Ish-kandidati për president Bernie Sanders foli përpara mbështetësve në Kansas. "Lufta për kontrollin e Dhomës së Përfaqësuesve është jashtëzakonisht e rëndësishme dhe mund të arrihet ndryshimi me një, apo dy të zgjedhur. Nëse ju arrini atë që unë e di se keni mundësi të bëni, ky do të jetë një votim që do të dëgjohet jo vetëm në mbarë vendin, por edhe në mbarë botën", deklaroi senatori Bernie Sanders.

Demokratëve u duhet të fitojnë rreth një duzinë vendesh për ta marrë shumicën në Dhomën e Përfaqësuesve, si dhe dy vende për shumicën në Senat. Krahas energjive të shtuara gjatë këtij viti, demokratëve duhet t'u

vijë në ndihmë edhe historia. "Zgjedhjet e mesmandatit zakonisht favorizojnë partinë që nuk ka Shtëpinë e Bardhë. Madje në këtë rast, Donald Trumpi është veçanërisht jopopullor mes demokratëve. Ata janë të motivuar, nuk e pëlqejnë dhe dëshirojnë të votojnë", thotë John Fortier, i Qendrës për Politikën Dypartiake.

Por, presidenti Trump po u bënë thirrje mbështetësve të sfidojnë historinë dhe të dalin për të votuar në mbështetje të axhendës së tij.

Të dyja partitë i perceptojnë zgjedhjet e mesmandatit si një referendum për presidentin.

"Rrallë kemi pasur një president që është kaq i përqendruar te zgjedhjet dhe kaq i rëndësishëm për to. Ai është Dielli. Gjithçka tjetër që rrotullohet rreth Diellit, është ose një planet, ose një Hënë", thotë Larry Sabato, i Universitetit të Virxhinias.

Për shkak të nivelit të ulët të miratimit ndaj Trumpit, si dhe historikut të rezultateve të zgjedhjeve të mesmandatit, demokratët kanë gjasa të fitojnë

terren. "Mendoj se pyetja shtrohet nëse është një valë demokrate, apo një tsunami demokrat? A do ta marrin demokratët Dhomën e Përfaqësuesve me 5 vende më tepër, apo me 30 vende? Këtë nuk e di njeri ende", mendon Elaine Kamarck, e Institutit Brookings.

Por, për shkak të bazës besnike të presidentit Trump, republikanët mund të dalin më mirë se ç'pritet thotë ish-menaxheri i fushatës Trump, Corey Lewandowski. "Mendoj se demokratët do të fitojnë disa vende. Por, nëse zgjedhjet do të bëheshin sot, republikanët do ta mbanin mazhorancën në Dhomën e Përfaqësuesve me 1 ose 2 vende më shumë", thotë Lewandowski.

Në nëntor vendoset për të 435 vendet në Dhomën e Përfaqësuesve, si dhe për rreth një të tretën e 100 vendeve në Senat. Rezultati do të ketë një ndikim madhor te dy vjetët e ardhshme të presidencës Trump.

Irani i bën thirrje Evropës t'i ndjekë interesat e saj



TEHERAN, 29 KORRIK - Ministri i Jashtëm i Iranit, Javad Zarif, tha në një konferencë me gazetarë të dielën se vendi i tij po punon me fuqitë evropiane për t'u siguruar, që ende mund të përfitojë nga marrëveshja bërthamore. Por nga ana tjetër, Shtetet e Bashkuara kanë thënë se të tjera sanksione do të rivendosen në muajin nëntor ndaj Iranit, pasi presidenti Donald Trump njoftoi në muajin maj se ShBA-ja do të tërhiqet nga marrëveshja.

Kryediplomati iranian Javad Zarif tha se Amerika është e prirë për të vënë sanksione. "Jam i sigurt që është e mundur. Kam besim se gjatë muajve në vazhdim ne mund t'u tregojmë amerikanëve se duhet të heqin dorë nga prirja e tyre për sanksione.

Një grup senatorësh republikanë paralajmëruan të enjten vendet evropiane që të mos i nënvlerësojnë sanksionet amerikane ndaj Iranit. "Sot, evropianët duhet të

vendosin nëse bizneset e tyre, bankat dhe qeveritë duhet t'i shikojnë interesat evropiane, apo interesat amerikane dhe veçanërisht interesat e Donald Trumpit", u shpreh kryediplomati iranian.

Britania, Franca, Gjermania së bashku me Kinën, Rusinë, Bashkimin Evropian dhe Iranin ishin palët e tjera në marrëveshjen bërthamore që ishte një nga arritjet e presidentit Barack Obama në politikën e jashtme.

Orbani sulmon shtetet 'jodemokratike' të Evropës Perëndimore

BUDAPEST, 29 KORRIK - Kryeministri i Hungarisë, Viktor Orbani ka sulmuar ato që ai i quajti shtete "jodemokratike" të Evropës Perëndimore dhe sërish ka shprehur qëndrimin e tij për një Evropë të krishterë dhe "joliberalë". "Ka liberalizëm në Perëndim, por nuk ka demokraci", tha Orbani gjatë një tubimi me hungarezët etnikë në Rumaninë fqinje. Ai tha se cen-

sura është "bërë e zakonshme" në Evropën Perëndimore dhe se vendet atje kanë imponuar "kufizime në lirinë e shprehjes". Orbani, që është nacionalist i krahut të djathtë, në mënyrë specifike ka sulmuar Komisionin Evropian, të cilin e ka cilësuar si "simbol të dështimit". "Komisioni Evropian po shkon, ne po vijmë", tha Orbani për këtë institucion të

Bashkimit Evropian që propozon legjislacion dhe zbatimin e vendimeve dhe traktateve. Kryeministri hungarez tha se zgjedhjet që do të mbahen vitin e ardhshëm në Parlamentin Evropian do të dominohen nga "një temë serioze dhe e përbashkët -emigracioni".

Orbani u bëri thirrje partive të krahut të djathtë që t'i bashkojnë

forcat dhe që të gjitha "të përqendrohen në zgjedhjet evropiane të vitit 2019" dhe që ta vënë migracionin në krye të agjendës së tyre. "Demokracia e krishterë nuk është liberale. Është joliberalë, nëse dëshironi ta quani kështu", tha Orbani, i cili në muajin prill fitoi mandatin e tretë radhazi, për të qeverisur me shtetin hungarez.



Fjalë e mbajtur në konferencën shkencore "40 vjet veprimtari shkencore e krijuese të prof. dr. Sabile Keçmezi-Basha"

Binomi histori, letërsi në veprimtarinë e prof. dr. Sabile Keçmezi-Basha



Prof. dr. Izber HOTI

Ani pse shprehja binom është shprehje algjebrike, unë nuk gjeta nocion më të afërt për të cilësuar në mënyrë më të shkurtër, më të saktë dhe më të mirë për veprën jetësore të Sabile Keçmezi-Bashës. Në të vërtetë, mendoj se me plot të drejtë mund të thuhet se puna publike e Sabile Keçmezi-Bashës, përkatesisht shkrimet e saj, sepse ajo, siç dihet nga biografia e saj, kreu Fakultetin e Shkencave Politike në Beograd dhe një kohë u mor edhe me politikë, por më shumë iu përkushtua historisë dhe letërsisë. Mbështetur në njohuritë e fituara gjatë shkollimit, por edhe të atyre të mëvonshme, Sabile Keçmezi-Basha vërtetoi gjithanshëm zbatimin e këtij binomi edhe në shkencat shoqërore dhe art, më saktë në histori e letërsi, duke vërtetuar se edhe në këto fusha ky binom përbëhet prej dy termash të bashkuara me shenjën plus ose minus, që kanë ndërmjet tyre lidhje të dyanshme, herë duke lënë në mangësi fushën tjetër, por pa humbur kurrë binomi histori - letërsi, shoqëruar nganjëherë edhe me politikë, ashtu siç është, dashur dhe padashur, edhe kjo jetë, të cilën që herët Sabilja e provoi edhe me gëzimet dhe hidhërimet, edhe me lehtësitë e vështirësitë, edhe me varfëritë dhe pasuritë e saj...

Binomi histori, letërsi shihet edhe nga diakronia e publikimeve të kontributeve dhe të veprave të shumta të Sabile Keçmezi-Basha. Lista e botimeve të kësaj autoreje herë është më e pasur me letërsi e herë me histori, mirëpo prurjet janë të theksuara në të dy fushat, sikur kjo bëhet me qëllim për të mohuar apo edhe të vërtetuar thëniet kundërthënëse të Platonit, të parafrazuara shkurtimisht në pohimet se "Poezia është më afër së vërtetës jetësore se historia, ndërsa poetët shqiptojnë gjëra të mëdha dhe të mençura, të cilat as vetë nuk i kuptojnë". Sot do të ndalesha vetëm sa për të dëshmuar se sa ka ndikuar Historia në shkrimet letrare dhe anasjelltas. (Sabile Keçmezi-Basha, Kodi i pritjes, Shoqata e Shkrimtarëve të Kosovës, Prishtinë, 2010, faqe 98) Nëse mbështetemi në postulatit se historia është vetë jeta dhe jeta histori, atëherë pothuajse të gjitha poezitë e Sabile Keçmezi-Bashës në veprën "KODI I PRITJES" mund të lexohen si poezi që i kushtohen historisë apo vetë jetës. Në të vërtetë, edhe vetë titulli i kësaj vepre ka këtë kuptim: gjatë gjithë historisë kombi shqiptar, si komb i pushtuar me shekuj, u përpoq të gjejë kodin e prit-

jes së lirisë, përkatesisht kodin e mbijetesës.

Natyrisht, në pritje për ditë më të mira, pra në pritje të ditëve të lirisë dhe në rrethanat e ndera jetësore, jo njëherë njeriu do të gjendet në pozitën "Pa çka (po çka - I. H.) / Që qan Rozafa" (faqe 8) dhe madje do të pres edhe në kthetrat e shqiponjës: "Pritim ... Të na ngrohete / Ngrohtësia globale / Në majë stalagmiti". Kuptohet në "pritjen dhe ngrohjen" në majë stalagmiti vështirë mësohet matematika dhe nëse vargohen shekuj të tërë, aq më parë kur është fjala për "Yllin Polar" dhe "Rrugën diellore" (9). Në rrethana të tilla pritja plakot dhe vidhet, sepse "Nga pritja / duke pritur / në pritje" (13) jepet dhe grisit gjithçka, por jo edhe pritja, që në fakt është ëndra shekullore e lirisë, e cila kur të vijë "do të shpëruhet yjet nga qielli", ndërsa "Në gjuhën e gjarprit / Do të shkulet jatagani", duke mundësuar kështu "qepjen e lëkurës së plagosur të Atdheut, si dhe marrjen e këngës malësorçe, pra të një lirie të mirëfilltë kombëtare "Se liria pa lirinë / Nuk do të ketë emër / As mbiemër" (14).

Për lirinë me emër dhe mbiemër

Liria me emër dhe mbiemër e shqiptarëve të pushtuar ishte lektisje e vërtetë dhe kjo në mënyrë artistike shprehet edhe nga poetja Sabile Keçmezi-Basha. Ajo pohon se kjo lektisje ishte aq e madhe sa nuk mund të shkohej në fletë papirusi e as në kohë, prandaj "Atë që kishim trumbetuar / Në tryezat e botës / E kërkuam në shekullin e ri". Kuptohet, si "pelegrin i lodhur" dhe "Duke lëpirë / Ajkën nga buzët" (15) e kërkon atë, sepse "Në Arbëri edhe sot / bie shi ... dhe rragaten stinët" (16), ndërsa "Humbëtura humbur kishte / Nisjen për t'u nisur / Në udhët që ktheheshin / Në udhëtarët që shkonin përtej harrimit" (17). Mirëpo, as në këto rrethana autorja nuk pranon "ta ndërpres lojën", të "përmyt ëndrrat" dhe të kërkojë "gjërat që nuk falen dhe gjerat që nuk blihen" (19), edhe përkundër faktit se "dhembjet janë kërpnajë" e "lumturia magjepse mbetet oqean" (20).

Shpirtin e poetit, përkundër gjithë këtyre dhembjeve të pashkëputshme dhe dëshirave për një liri me emër dhe mbiemër, më së shumti e shqetësonin përqeshja në "zamanin çyryk" (21), akuzat për "nusen e fjetur pa pikë taksirati" (22), duke formuar kështu zigzage të "fatit e të fatkeqësisë" në kohën kur "Lëkura e atdheut digjej... digjej / Bashkë me memorien" (23). Pra, për autorin, Sabile Keçmezi-Basha, krahas mynxyrave të tjera që goditën popullin shqiptar gjatë ecejakeve (historisë) "me miliona copa të thyera" (24), në të cilën kishte mbetur "pak vend për lumturi dhe shumë vend për dhembje" (25), është tejet shqetësues "djegia e memories", përkatesisht harrimi i së kaluarës,

duke "u abortua edhe molla e kuqe" (26).

Harrimi i Mollës së Kuqe, që siç dihet nga historia ishte vend thellë në Sanxhakun e Nishit, si dhe kërkimi i zgjidhjes së çështjes së lirisë shqiptare, mund të thuhet se janë materie kryesore historike që Sabile Keçmezi-Basha i trajton artistikisht në pjesën e parë të kësaj vepre të titulluar Kodi i pritjes, prej nga edhe e mori emrin e gjithë vepra.

Vështirësitë e frymëmarrjes

Cili ishte kodi i pritjes autorja nuk shpjegon drejtpërdrejt, por lë të nënkuptohet. Si do që të jetë autorja e veprës Kodi i pritjes, Sabile Keçmezi-Basha, në vazhdim elaboron me elokuencë kohën e cila shkurt do të vlerësohej e një pjesë e kësaj vepre edhe do të titullohet: Sa pak oksigjen, që s'ka dyshim është veçori përshkruese e rrethanave mbizotëruese të kohës së robërisë, apo të kohës kur bëhen "shumë sorollatje për pak oksigjen", bile sa për një "ecje vertikale" dhe "një proces - katalizator" (29). Është koha kur nuk mund të tregohet si jetohej dhe si mund të nxirret "tharmi i jetës" (30), kur flitet "Për kthimin biblik / Në tokën e djegur", si dhe kur bëhet fjalë për "ritakimin dhe rindarjen" (31) dhe për dhembjen që godet tokën, shpirtin e shtetit, madje edhe vetë dhembjen. Është kohë e pa kohë, kur "grisen këmishët e dalmatet e bardha, të shoqëruara me shkullje flokësh e me lot syri si kokrra rrushi, si dhe kur "Penelopat janë mplakur / Nga pritja e pritur / Në udhëkryq motesh" (32-33). Por, as në këtë kohë katrahurash, thekson autorja, nuk u ndërrua fytyra: "Kurrë nuk lakmova / Një fytyrë / Një tjetër botë / Dhe një fat tjetër". Kini kujdes: as tjetër fat. Shqiptari në këtë kohë nuk dëshiron të ndërrojë as vend, por kërkon "Vetëm pak diell / Pak ngrohtësi / Pak liri" (34), sepse vetëm kështu do të kapërcehet "universi ku zhvillohen betejat dhe ku ushtarët nga të dy anët mbeten pa fitimtarë", si dhe vjeshta e lotuar, duke arritur në "udhëtimin e tej muzgut të kohës së sëmur" (35).

Në(n) samarin e historisë

Udhëtimi artistik në kohë dhe çështje të ndryshme nga e kaluar dalëngadalë do ta sjell autorin, Sabile Keçmezi-Basha, në një formë më të drejtpërdrejtë të shprehjes së ndjenjave të grumbulluara si një pjesëtare e një populli me histori të pasur - në samarin e historisë, unë do të thosha edhe nën samarin e historisë. Autorja është e bindur, pa dyshim më tepër se duhet, por që i lejohet poezisë, se pasi "nuk e mësuam historinë ... duhet kuvenduar me varre të atdheut, me ADN-të e mbetur dhe gjeografinë e dhembjes". Ndodhi kështu ngase skedarët e pluhurosuar arkivorë... nuk patën dritë: "E dhembja migroneze e har-

rimin / Shteron kroin e pafund të kujtesës", ndërsa si pasojë "Historinë duhet mësuar me mur e muranë" (36).

Në(n) samarin e historisë vikendet janë të lodhura, ngushëllimet dhe dhembjet do të përsëriten me udhëkryqe, ura të Siratit, dhembje largësie dhe pritje apokaliptike (38-39). Që të luftohen të gjitha këto duhet "kërkuar nëpër mote", ndoshta edhe duhet bërë Doruntinë e Konstadin (40), duhet kujtuar (duhet parë ëndërr) Itakën, Formulën e Pagëzimit, gjarprin e shtëpisë, arkën e gjyshes, të cilat ndoshta do të na çojnë në hotelin "Nirvana" (43), ku do të gjejmë kuptimin e jetës dhe të qetësisë shpirtërore të mënyrës dhe të formës së Lindjes së Largët. Vetëm atëherë "kafka e lodhur" e shekullit do të mendonte për premtimet dhe për trajtën e lirisë (44-45).

Kthimi (i serishëm) në histori

Përpjekjet e gjetjes së qetësisë së historianes poete do të zgjasin shumë. E kaluara do të vazhdojë ta shqetësojë atë mu sikur pritja dhe ajo nëpër arkiva do të hulumtojë "vegjet historike", me të cilat do të mësojë, për të mos thënë do të krijojë "anatominë e tkurjes" gjeografike të atdheut falë "burrave të botës", të cilët "sharonin globin" (48-49). Mirëpo, për këtë gjendje tonë abisi nuk ishin fajtorë vetëm të huajt, sepse "Lirë shitëm / Edhe ato që nuk shiten dot" (50-51), ndërsa "Ende pa filluar mirë dita (lexo liria - I. H.) / Plasi sherrit" dhe "Tri herë kalova / Rrugës kryesore të Prishtinës / Askënd nuk njoha", aq shumë jemi të huajsuar dhe armiqtë sa nuk ka si të mos "dhemb fort apokalipsi që do të ndodh" (52).

Situata rëndohet edhe më shumë kur vajtoret "përmallshëm për fëmijërinë dhe koka dhemb nga dëftimi i robërisë së pasosur", aq më parë kur "Është vonë për një përgjërje / Për ditët që shkuan" (54-55), "kur s'ka rrugë me dy kahe" dhe kur premtimet janë djegur (59).

Gjysmat si qeshje të ngrira

Kur mbetesh i pakënaqur me të kaluarën dhe të tashmen nuk mbetet asgjë tjetër veç në fytyrë të paraqitet një Qeshje e ngrirë. Kështu edhe është titulluar pjesa e fundit e poezive të veprës Kodi i pritjes të Sabile Keçmezi-Basha. Nënqeshja, apo qeshja e ngrirë është pasojë e vrapit për zënien e kohës dhe të diellit, prandaj "qeshja është e çarë kudo në dysh", edhe kur është fjala për shpirtin mitik (63). S'ka si të ndodh ndryshe kur kombi shqiptar ka edhe shumë ëndra që barten nga brezi në brez, të shoqëruara me dhembje të padiagnozuara (64). Në një situatë të tillë s'mbetet tjetër veç të "fluturojmë në Mahtatan e Pekin për të ringjallur mëmëdhenë, për të ndezur qirium, për të mësuar mesazhet e

paqes të JanPalahut e Dalaj Lamës, ani pse muret (e Berlinit dhe ai kinez) kërcënohen "Për ndarje / Në ndarje" (66-67), prandaj pritet "Përsëri furtunë / Acar e frikë / Nga dita e panjohur", pasi u gënjem sepse nuk ishin mbytur çakejtë e kuçedrat, ani pse kështu ishte deklaruar (68). Edhe në këto rrethana s'mbete gjë veç lutjeve të Dalaj Lamës në Tibet me fytyrë nga dielli si antipodi i "mëngjesit polar" në Ballkanin me stinë të vonuar (68-70). Ndodh kështu ngase "Përsëri nuk na doli / Ashtu siç ëndërruam" dhe derisa dje përsëritet me dy gishta: "Sot shi ra kërpnajë / Dhe haruam të përsëritetemi / Edhe me kipcat tanë (72-73).

Edhe në rrethanat e lartpërkshkruar autorja nuk bie në pozita pesimiste dhe për të vazhduar jetën thërret sërish në ndihmë ëndrrat dhe pritjen (74), kurse e forcuar nga këto shpresa ajo edhe falë: "Nuk gjykoj / As për dije / As për sot / As për nesër ... " (75), megjithatë dilemat në mes Mic Sokolit, Adem Jasharit e Dalaj Lamës mbeten se mbeten me ndryshime si pas "natës së parë të nuses së nusëruar" (76-78), që nuk duhet lënë vetëm se bëhet pre e ujqve, hienave dhe lugetërve. Me këtë rast stuhia në Ilirinë e stërgjyshave është e pakapërcyeshme e të këqijat do të vargohen palë-palë me qeshje të hidhura, përgjërime ecejakesh e mjegullnash (82-85), që me vrap maratonik e metaforash, apo me qarje dhe qeshje nuk do të mund t'u dilet përpara dhe të pengohen këto rrjedha (85-89).


Në kohën e fitimit dhe mbizotërimit të këtyre rrjedhave dhe në kohën e llahtarshme dhembjet do të jenë aq të mëdha "Sa shumë dhemb / Kur ç'kapet / Mishin nga thoi", por ne atëherë do të topitem aq shumë sa as atëherë nuk do të qajmë (91). Është pra koha kur kërkohet harta e grisur e shoqëruar me qitjen e gjuhës nga ana e mesjetës (92), por edhe e kohës kur Atdheut i kërkohet falje për rrefimin e ëndrrës dhe drithërimin e fundit në prag të ikjes (93), si dhe kur jemi të detyrueshëm të kërkojmë falje pse qeshim dhe pse qajmë, për të bërërat dhe të pabërërat, që përfunduan në natën-skëterrë. Atëherë, fatkeqësisht, duhet kthyer dhe kërkuar sërish "Kodin e pritjes". Kjo qasje dhe ky qëndrim sikur është i natyreshëm për Sabilen. Ajo shpirtërisht shkruan për dashurinë e përjetuar për njerëz, në kundërshtim me letërsinë e filozofinë popullore, por edhe letërsinë e shkruar. Në anën tjetër, Sabile Keçmezi-Basha natyreshëm i sheh, i kupton dhe i trajton nacionalitet dhe komunistët, që është veçori e kërkuar jo vetëm nga historiografia shqiptare, por edhe ajo botërore, çështje kjo që kërkon më shumë kohë dhe mund për shqyrtim.

Më vjen mirë që e njoha Sabile Keçmezi - Bashën si poete, historiane e politikane dhe që së bashku vepruam dhe kontribuam një kohë kur vërtetë ishte e nevojshme.

E jashtëzakonshme

Mostra misterioze e detit lahet në plazhin filipinas

Shumë të habitur, vendësit u përpoqën të kuptojnë se çfarë mund të jetë ajo krijesë masive e paidentifikuar e cila gjendej në plazhin filipinas. Krijesa rrëqethëse e bardhë, u filmua teksa lundronte në cekëtinë në Mindoro.



BARSOLETA E DITËS



I thotë biondja shoqes së vet:

- Paramendo, dje u ndal rryma, mbeta në ashensor një orë rrafsh!
- Po kjo nuk është asgjë. Unë kam mbetur tri orë në shkallët lëvizëse.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit
në ora 16:00

“INCREDIBLES 2” 3D

I Animuar/Aksion/Aventure; 1 ore 58 min

Rolet: Holly Hunter, Craig T. Nelson, Sarah Vowell, Huck Milner, Samuel L. Jackson, etj.

Regjia: Brad Bird



FOTO E DITES



Punëtorët e emergjencës shihen midis automjeteve të dëmtuara në një zonë të hapur parkimi të Athinës së veriut. /AFP/


Në ora 18:20

“FUTURE WORLD”

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

Rolet: James Franco, Suki Waterhouse, Milla Jovovich, Lucy Liu, Jeffrey Wahlberg, Snoop Dog, etj.

Regjia: James Franco



Në ora 20:00

“ANT-MAN AND THE WASP” 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 58 min

Rolet: Paul Rudd, Evangeline Lilly, Michael Pena, Michael Douglas, Michelle Pfeiffer, Laurence Fishburne, etj.

Regjia: Peyton Reed



E rrallë

Kopshti zoologjik 'shet' gomarin për zebër

Një kopsht zoologjik në Egjipt ka gjetur një mënyrë interesante për të tërhequr vizitorë duke lyer me ngjyra gomarin që të duket si zebër. "Kurthi" u zbulua nga studenti Mahmoud A. Sarhani që vizitoi parkun e Kairos dhe fotografia u bë virale në internet.



Në ora 22:00

“LOVING PABLO” (R)

Biografi/Krim/Drame; 2 ore 03 m

Rolet: Javier Bardem, Penélope Cruz, Peter Sarsgaard, etj.

Regjia: Fernando León de Aranoa



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.




DASHI

Asnjë nga çështjet e programuara për sot nuk do të shkojnë siç e kishit planifikuar. Çdo çast do të sjellë të reja.



DEMI

Dita është e mbushur me impenjime në punë dhe në familje. Keni lënë shumë gjëra pas dore.



BINJAKËT

Sensi juaj i humorit do të mbizotërojë sot gjatë gjithë ditës. Fëmijët janë ata që do të kënaqen në shoqërinë tuaj.



GAFORRJA

Dita sot është e mbushur me çaste aspak të këndshme. Keni kundër këdo që do të takoni në rrugën tuaj.



LUANI

Sot jeni gjatë gjithë kohës në komunikim me partnerin si në mënyrë virtuale ashtu edhe drejtpërdrejt duke parë njëri-tjetrin në sy.



VIRGJËRËSHA

Megjithëse jeni një nga shenjat më kursimtare të Zodiakut, sot do të shpenzoni për të bërë të lumtur një person të dashur.



PESHORJA

Do të jeni shumë të ndjeshëm dhe nuk do të bëni asgjë për ta fshehur këtë ndjenje. Ditë me ulje dhe ngritje humori.



AKREPI

Çdo gjë shkon mirë ditën e sotme dhe nuk do të ketë shumë ngjarje për t'u shënuar. Ditë e qetë do të jetë me miqtë.



SHIGJETARI

Shoqëria dhe dashuria nuk shkojnë aspak mirë në orbitën tuaj sot. Duhet të zgjidhni midis miqve dhe partnerit.



BRICJAPI

Entuziazmi juaj është ngjites sa do të përçohet edhe tek ata njerëz që ju rrinë pranë.



UJORI

Për shkak të një jave mjaft të ngjeshur, sot ndiheni të lodhur dhe doni të pushoni. Ju mjafton qetësia e shtëpisë suaj.



PESHQIT

Kujdes me veprimet që bëni sepse nuk do të keni përkrahje nga miqtë tuaj. Duhet ta vazhdoni vetëm rrugën tuaj.

Kanye West flet hapur për dëshirën e tij për vetëvrasje



Kanye West ka folur publikisht me sinqeritet për dëshirën e tij për vetëvrasje pasi ka shikuar dokumentarin për Alexander McQueen. Në llogarinë e vet në "Twitter" 41-vjeçari ka thënë se e ka shikuar dokumentarin dhe ka gjetur veten te disenjatori britanik i modës, i


cili bëri vetëvrasje në vitin 2010. "E kam shikuar dokumentarin e Alexander McQueen dhe jam lidhur me rrugëtimin e tij. Unë e di se si është ndjenja e dëshirës së kthimit të jetës tënde në duart e tua edhe nëse kjo do të thotë vetëvrasje", ka thënë Westi.

Gwyneth Paltrow pranon se ka frikë nga martesat për herë të dytë



Aktorja 45 vjeçare Gwyneth Paltrow, e cila do të martohet me producentin Brad Falchuk, ka folur për këndvështrimet e saj mbi dashurinë dhe martesën në emisionin e Sarah Jessica Parker. "Unë jam gati të martohem përsëri", ka thënë

Paltrow në fillim të intervistës, duke shtuar se, ndonëse është "pak e frikësuar", ajo është "shumë optimiste". Ajo ka thënë se tani është në një pozicion krejt ndryshe sesa ishte kur u martua me bashkëshortin e parë, Chris Martin, një dekadë më herët.



Enca e kënaqur që performoi në të njëjtën skenë sikurse Daddy Yankee

Këngëtari i famshëm Daddy Yankee të premtën ka mbajtur një koncert të madh në Sheshin "Skënderbej" në Tiranë, ku ka argëtuar mijëra qytetarë të cilët kishin shkuar enkas për ta parë. Pjesë e koncertit ishin edhe këngëtarët shqiptarë, në mesin e të

cilëve ishte Enca Haxhia. Ajo ka pasur rastin të takohet me kantautorin nga Porto Riko dhe të bëjë fotografi me të. "Ishte kënaqësi të të kishim në Tiranë dhe të performoja në të njëjtën skenë sikurse ti, Daddy Yankee", ka shkruar Enca në "Instagram".

Pas aksidentit, George Clooney dhe Amal në darkë me miq

Aktori George Clooney, së bashku me gruan Amal Clooney, duken se kalojnë për mrekulli. Ata janë shfaqur për adhuresit e tyre gjatë darkës në mbrëmjen e së shtunës. Pas

aksidentit të fundit që patën, ata përsëri po shijojnë çaste fantastike me miq. Çifti i Hollywoodit u panë në Villën D'Este, në liqenin Como të Italisë.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE	LOTTE - MEPPEN	2	BRETOIS - METZ	1	VEJLE - AGF AARHUS	GG3+
-------------------	----------------	---	----------------	---	--------------------	------

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, priti në takim krerët e Federatës së Futbollit të Gjermanisë

Federata e Futbollit e Gjermanisë konfirmon përkrahjen për sportin e Kosovës

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, gjatë takimit me krerët e Federatës së Futbollit të Gjermanisë, nënkryetarin e parë Rainer Koch dhe nënkryetarin tjetër Rainer Milkoriet, ka falënderuar shtetin gjerman për kontributin që ka dhënë për Kosovën në fushën e sportit

"Epoka e re"

PRISHTINË, 29 KORRIK - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka pritur të dielën në një drekë pune krerët e Federatës së Futbollit të Gjermanisë, nënkryetarin e parë Rainer Koch dhe nënkryetarin tjetër Rainer Milkoriet. Me këtë rast, ministri Gashi ka falënderuar për vizitën që përfaqësuesit e DFB-së ia bënë Kosovës, gjithashtu ka falënderuar për

kontributin që kanë dhënë për Kosovën në fushën e sportit. Gjatë takimit diskutuan lidhur me bashkëpunimin që do ta vazhdojnë në të ardhmen. Ministri Gashi ka shprehur keqardhje për anulimin e ndeshjes testuese e cila është paraparë të zhvillohet të shtunën, por është shtyrë për shkak të vdekjes së veprimtarit të shquar, Adem Demaçi. "Jam i gatshëm ta vazhdojmë bashkëpunimin tonë në fushën e sportit ne si Ministri e Sportit. Prioriteti ynë është t'i

mbështesim federatat sportive dhe të jemi gjithmonë afër sportistëve tanë të cilët po na bëjnë krenarë me sukseset e tyre anekënd botës", ka thënë Gashi. Duke falënderuar ministrin Gashi për këtë mikpritje kaq të ngrohtë, Rainer Koch ka pohuar se me Kosovën ka disa çaste të mira. "Kur jam këtu nuk kam si të mos e kujtoj ish-presidentin Vokri i cili ishte një njeri i madh. Unë pata rastin ta takoj në Kongresin e FIFA-s më 13 maj 2016, ku në atë kongres për herë



të parë po e përfaqësoja DFB-në. Më kujtohet mirë fjalimi i ish-presidentit Vokri, por edhe kundërshtimi i kryetarit serb. Unë këtu jam ta përfaqësoj jo

vetëm veten time, por edhe DFB-në. Ju siguroj se do ta vazhdojmë bashkëpunimin në të gjitha fushat sa i përket zhvillimit të një ndeshje", ka thënë Koch.

Akil Gjakova, i artë në Grand Prix Zagreb 2018

PRISHTINË, 29 KORRIK (ER) - Akil Gjakova (-73 kg) ka shkëlqyer në Grand Prix të Zagrebit me pesë fitore në një konkurrencë shumë të fortë. Në gjiron e parë Akili ishte i lirë, në ndeshjen e parë mposhti me ippon garuesin zviceran Stump Nils. Në ndeshjen e dytë mposhti me wazari garuesin nga Emiratet e Shteteve Arabe, Victor Scvortov. Akili në ndeshjen e tretë mposhti me ippon ukrainasin Artem Khomula.



Në gjysmëfinale mposhti me wazari dhe ippon nënkampionin Olimpik dhe Botëror aktual, garuesin nga Azerbajxhani, Rustam Orujov.

Finalja ishte një ndeshje kundër kampionit olimpik aktual, italianit Fabio Basile, të cilin e mposhti me wazari për t'u stolitur me medalje të artë. Ministri i Kulturës, Rinisë dhe

Sportit, Kujtim Gashi, i është gëzuar këtij lajmi. "Akil Gjakova i artë. Akili edhe sot në Grand Prix Zagreb 2018 shkëlqeu në mënyrën më të mirë të mundshme. Ai doli i pari në konkur-

rencën prej 56 garuesve. Akilit dhe trajnerit Driton Kuka i urojmë suksese në rrugën drejt Lojërave Olimpikë - Tokyo 2020", ka shkruar Gashi në llogarinë e vet në "Facebook".

Thaçi: Po të pyetesha unë, stadiumi kombëtar i Kosovës do ta mbante emrin e Adem Demaçit

PRISHTINË, 29 KORRIK (ER) - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka dhënë opsionin e tij për emrin se si duhet ta mbajë Stadiumi Kombëtar i Kosovës, i cili do të ndërtohet në një hapësirë prej 25 hektarësh në Sankoc të Drenasit, 14 kilometra larg Prishtinës. Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se stadiumi kombëtar i Kosovës duhet ta

mbajë emrin e simbolit të pavarësisë së Kosovës, Adem Demaçi. "Po të pyetesha unë, stadiumi kombëtar i Kosovës do të duhej ta mbante emrin e simbolit të bashkimit, të lirisë dhe të pavarësisë së Kosovës, z. Adem Demaçi", kështu ka deklaruar vitin e kaluar (më 17 shkurt 2017) presidenti Thaçi në një intervistë dhënë gazetës "Epoka e re".



Kombëtarja U-19 do t'i zhvillojë dy ndeshje miqësore në Slloveni

PRISHTINË, 29 KORRIK - Kombëtarja e Kosovës U-19 do t'i zhvillojë dy ndeshje miqësore kundër kombëtares së kësaj grupmoshe të Emirateve të Bashkuara Arabe. Ndeshjet do të zhvillohen në Slloveni,

më 6 dhe 8 gusht. Grumbullimi i futbollistëve të Kombëtares U-19 do të bëhet më 2 gusht, në orën 16.00, në stadiumin "Agron Rama" në Obiliq. Përzgjedhësi Ramiz Krasniqi

për këto dy ndeshje miqësore ka ftuar këta futbollistë: Flamur Gashi, Laurit Behluli, Art Maloku, Bernard Kastrati, Leonit Vitija, Albin Kapra, Ilir Krasniqi, Muhamet Hyseni, Endrit Demolli, Enbia Shehu,

Albin Krasniqi, Alban Shabani, Albion Pllana, Maxi Rugova, Gentrin Limani, Altrim Pajaziti, Loti Celina, Kreshnik Krasniqi, Enis Kavkazi, Leutrim Reka, Alban Kadrija dhe Gentrin Gashi.



Sarri tregon për të ardhmen e Hazardit

Londër, 29 korrik - Trajneri i Chelseas, Maurizio Sarri, ka folur për të ardhmen e yllit të kësaj skuadre, Eden Hazard,

në sezonin e ri. Ai ka thënë se Hazardi mbetet pjesë e padiskutueshme e klubit londinez. "Hazard? Mbetet

në Chelsea. Është një lojtar i fortë. Të gjithë trajnerët do të kishin dëshirë ta stërvitnin. Por, lojtarët e fortë

duhet të mbeten të motivuar dhe shpresoj t'i japim motivimin e duhur", ka thënë Sarri.



Gattuso në rrezik? Milani s'heq dorë nga Conte

MILANO, 29 KORRIK - Pavarësisht prej deklaratave të Leonardos, drejtorit të ri të përgjithshëm të kuqezinjve, se klubi do ta vazhdojë projektin me Genaro Gattuson në stol, mediet italiane kanë zbuluar se në ditët e fundit ka pasur një takim mes brazil-

ianit dhe ish-trajnerit të Chelseait për t'i kuptuar mundësitë që ekzistojnë që Conte ta marrë drejtimin e Milanit. Leonardo i ka bërë me dije Contes dëshirën e tij që ai të ulet në bankinën e kampionëve të Evropës. Ai ka pyetur nëse është e mundur

që Conte mund të lirohet sa më shpejt nga kontrata që mban të lidhur me Chelseain, me klubin londinez që aktualisht i paguan trajnerit italian pagën prej 9 milionë eurosh në sezon, ndërsa kjo shifër tani shkon deri në 17 milionë euro, përfshirë edhe taksat.



Chelsea vjen me ofertë për 34 milionë euro për Ramseyn

Londër, 29 korrik - Ylli nga Uells, Aaron Ramsey, mbetet pa kontratë apo lojtar i lirë në verën e ardhshme dhe Chelsea ka shprehur pothuajse gatishmërinë për të dhënë rreth 34 milionë euro për transferimin e tij. Chelsea ka emëruar para disa javësh Maurizio Sarrin trajner të ri të skuadrës dhe tani

është duke kërkuar përf forcime për t'i përmbushur dëshirat e tij. Një nga emrat më të përfolur për ta transferuar gjatë këtij afati kalimtar veror është mesfushori Ramsey. Sipas "Daily Mail", blutë janë të gatshëm për të nënshkruar me mesfushorin e Arsenalit për 34 milionë euro.



Moura: Tottenhami është klub më i madh se PSG-ja

LONDËR, 29 KORRIK - Lucas Moura ka folur për klubin e tij, Tottenham Hotspur, të cilin e ka cilësuar më të madh se ish-klubi Paris Saint-Germain. Ylli brazilian ka zhvilluar një ndeshje të mirë në humbjen në penallti nga Barcelona në kuadër të International Champions Cup. Në këtë vit Moura do të luajë nga fillimi i kampionatit për Spursin pasi te anglezët erdhi vetëm në gjysmë

